

HEJZA



Blerina Rogova Gaxha

SHKRIMTARËT E NDJEJNË PULSIN E KOHËS

TË SHKRUASH PËR LETËRSINË

Letërsia nuk është as thashetheme rrugësh dhe as intrige që rrjedh si status nëpër facebook, apo rrjetet e tjera sociale. Letërsia, ashtu si edhe arti, janë një shkallë e lartë e emancipimit shoqëror



Kliton NESTURI

Të shkruash për letërsinë sot në Shqipëri është një budallëk. Madje, do të thosha është çmenduri. Letërsia nuk është as thashetheme rrugësh dhe as intrige që rrjedh si status nëpër facebook, apo rrjetet e tjera sociale. Letërsia, ashtu si edhe arti, janë një shkallë e lartë e emancipimit shoqëror.

E them me dhimbje këtë, pasi shoh se jeta shqiptare, si asnjëherë më parë, sa po vjen e po jepet pas gjërave të lehta, rrjeteve sociale ku qëlon populizmi dhe perversiteti, thashethemeve dhe intrigave, gjërave që prodhojnë vetëm stres, jetë boshe dhe

asgjë më shumë. Duket sikur tek shqiptarët jeta e ka humbur kuptimin, dhe jetohe ngushtë, vetëm sot për sot, pa mundur të hidhet vështrimi drejt së ardhmes. Kësaj edhe temat për vlerat e larta njerëzore të shoqërisë që duhet të reflektojmë dhe ndërtojmë, mund të konsiderohen pa vlerë.

Tek po bisedoja me një mik të ngushtë, tek i cili besoj shumë për vlerat intelektuale dhe artistike, fjala ra në temën e letërsisë. Të dy ishim në një mendje, se sot letërsia në Shqipëri shkruhet, por pa hyrë në analizën se cili lloj i përket, vihet re se, si asnjëherë më parë se mungon fryma e debatit, e analizës së veprave.

Të flasësh për letërsinë apo për artin, nuk është se po flet për një vepër apo fushë të caktuar. Jo. Duke qenë se letërsia dhe artet kanë karkater reflektiv, ato gjenerojnë tema të pafundme njerëzore dhe sociale, nëpër të cilat kalon udha e shoqërisë. Aristoteli thoshte se "Teatri është katarsis". Këtë funksion ka sot arti në vetvete; Të prodhojë katarsis, duke e bërë shoqërinë edhe më të mirë, vazhdimisht më të mirë.

Pë hir të së vërtetës, në median e shkruar dhe elektronike, ekzistojnë suplemente letrare apo kulturore. Kjo është diçka e mirë. Por vetëm kaq. Deri më sot, të paktën dekadën e fundit, nuk është vënë re që këto

suplemente të karkaterizohen nga fryma a debatit, analizat e thella dhe përplasjet që e forcojnë klimën artistike dhe intelektuale. Kjo sepse këto suplemente duke ruajtur autorësinë një botuesi apo grupimi të caktuar, e kanë pasur të pamundur të dalin nga kornizat e tyre, apo shprehur më qartë, rrethi i ngushtë, për t'i dhënë hapësirë mendimit të pavarur dhe përplasjeve së ideve. E përkufizuar në një fjalë të vetme, forca e tyre ka qenë dhe është e butë (soft), çka nuk i ka shërbyer aspak klimës letrare dhe zgjimit të interesimit të lexuesit. Vetëm debati e nxit zhvillimin dhe bën që të kthehet vëmendja ndaj një teme apo një vepre të caktuar. Çdo gjë "e butë" kalon pa u vënë re.

A është e vërtetë kjo? Natyrisht që po. Por historia e këtyre tridhjetë viteve, na ka treguar se për veprat e artit, letërsisë, pikturës, muzikës, filmi, teatrit, vëmendja ka qenë shumë e ulët, çka dëshmon shkallën minore të emancipimit të shoqërisë shqiptare. Në Shqipëri dhe ndër shqiptarë, vëmendje kanë tërhequr vetëm debatet shterpe politike, debatet për ndërtesat e institucioneve, kronikat rozë, kronikat e zeza, apo thashethemet dhe intrigat e rëndomta që mbushin rrugët dhe rrjetet sociale. Është e dhimbshme, të mendosh që ky popull që nuk gjeneron vlera të larta të ndërtimit të shoqërisë, jeton në Evropën e mençur dhe plot kulturë.

Një komb udhëhiqet nga elitat, ata që shkruajnë përçojnë dhe reflektojnë ide dhe debate për ekonominë, perspektivën, zhvillimet sociale, artin dhe vlerat humane. Sa duket, në Shqipëri kjo klimë do të mungojë edhe për shumë kohë, pasi shqiptarët e kanë më të kollajshme që të rendin me ngulm drejt gjërave të lehta dhe jetës së varfër shpirtërore, thashethemeve të rrugëve dhe atyre që mbushin rrjetet sociale në internet, duke mos menduar fare për ballafaqimin që i pret me të ardhmen e afërt.

Pikëpamje

PËR POEZINË...

Ose shpirt të plotë, ose materie të plotë, lirika se do edhe këtë edhe atë, poezia është e shenjtë dhe do shenjtërinë e poetit

Sulejman MEHAZI

Arti nuk e do madhështinë, por bukurinë estetike, perceptimin shpirtëror. Shumica e poetëve vrapojnë për t'u bërë të mëdhenj, e nuk vrapojnë pas së bukurës artistike.

Ose shpirt të plotë, ose materie të plotë, lirika se do edhe këtë edhe atë, poezia është e shenjtë dhe do shenjtërinë e poetit. Të gjithë poetët e përmendur e të njohur në botë janë shpirtëror. Ata kurrë nuk kanë shkruar poezi për suksese, po për bukuritë shpirtërore, ky shpirt i pastër artistik bëhet universale, ky universalitet shndërrohet në bukuritë artistike. Shpirti i pastër poetik gjen motive të pastra, shpirtat e tolloviturit merren me tollovitje artistike.

Shpirti i sinqertë poetik të jep pastërti poetike, pastërtia poetike te jep motive të pastra, motivet e pastra të

japin ide të pastra për të shkruar, idetë e pastra të japin frymëzime të pastra, frymëzimet e pastra të japin bukuritë të pastra poetike, prej kësaj bukurie të pastër krijohet vargu i pastër, prej vargut të pastër krijohet strofat e pastra, prej strofave të pastra krijohet poezia e pastër, prej poezisë së pastër krijohet arti i pastër, prej artit të pastër krijohet bukuria shpirtërore, prej kësaj bukurie shpirtërore krijohet perceptimi poetik, prej perceptimit poetik krijohet estetika krijuese, prej kësaj estetike krijuese formohet arti i bukurisë, poezia.

"Poezia është pasqyrim gjuhësor i gjendjes që kalon në shpirt. Është transformim i menjëhershëm i ndjenjës në gjuhë. Poezia është melodi, kurse gjuha dhe rima janë vetëm mjete për shprehjen e kësaj melodie". (Y.K.Beyatliu)

"...A e keni vërejtur, për shembull,

poetët (pasi më së tepërmi kemi punë me poetë) për të qenë poet, duhet të jenë fetarë ose të dehur (pijanecë), nuk ka mundësi të jetë ndryshe ose të bëhen në mënyrë artificiale poet; arti me të gjitha dimensionet e veta është një Einfuhlung (gjermanët e kanë përdorur një term në estetikë, EINFUHLUNG - përjetim i ekzistencës së jashtme në brendinë tënde), për shembull, përjetimin e trëndafilut në brendi. Poeti, artisti, duhet ta fusë shpirtin e vet në çikrikun e shpirtit, ta luajë dhe këtë e bën nëpërmjet mjeteve që e largojnë funksionin e mendjes. I dehur, a e dini çka do të thotë? Domethënë, ta bësh budalla mendjen dhe ta lëshosh shpirtin të punojë, për atë të dehurit, shkruajnë poezi, për shkak se e heqin mendjen prej kontrolli; përderisa e keni mendjen aty, nuk mund të bëni as art, as poezi. Unë nuk ju them të pini alkool, Zoti mos e dhashtë, por ju them të bëni fetarë. Nuk ka nevojë të pimë alkool që të shkruajmë poezi, mjafton ta përjetojmë Zotin. Nëse lidhemi me Zotin, atëherë automatikisht, fillon të lëvizë motori dhe çikriku i shpirtit tonë, prandaj këtë Zot duhet ta njohim mirë..." (Prof. Dr. Metin Izeti, Dyzet net, I, Logos-A, 2015, fq. 177.)

Për hir të artit poetik që është pjesë përbërëse perceptuese e shpirtit, jemi të detyruar të reagojmë për shkak disa

përmbledhje të kota poezish antologjike në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë Veriore. Mos hyni aty ku nuk e keni vendin, për shkak se bukuria e harmonia qiellore e artit poetik nuk ju pranon të bëheni banor qiellor, dyert e qiellit poetik nuk hapen për çdo e grumbuj poetësh. Ligji mistik, i padukshëm i shpirtit qiellor për poezinë antologjike thotë: POEZIA ANTOLOGJIKE dallohet prej poezive tjera sikurse hëna pesëmbëdhjetë para yjeve, prandaj poezitë antologjike janë të pakta, numërohen me gishta e të përjetshme. Poezia antologjike zgjidhet nga bota qiellore e kurrësi nga bota njerëzore, është dhuratë qiellore e jo njerëzore, pikë. Princërit e poezisë antologjike asnjëherë nuk e quajnë veten poet, por të dashuruar, poezitë e tyre quhen serenata dashurie.

Poezia se duron ditën e 21 marsit, s'është njëditëshe, por e përjetshme, vendbanimi i poezisë është në shpirt jo në tubimet manifestuese njëditëshe të 21 marsit, Poezia se duron përkohshmërinë njëditëshe, po pakohshmërinë e përjetësisë.

Thelbi i poezisë është frymëzimi, thelbi i frymëzimit është inspirimi, thelbi i inspirimit është zemra, thelbi i zemrës është dashuria, thelbi i dashurisë është bukuria, thelbi i bukurisë është shpirti, thelbi i shpirtit është përjetësia, thelbi i përjetësisë është Zoti.

PUSHTETI I KULTURËS NË GRAHMËN E FUNDIT

Shtresat e elitës kulturore në Maqedoninë e Veriut gjithnjë e më shumë po fishken. Ato duan shpëtim dhe, shpëtimi i tyre është vetëm në themelimin e fondeve si institucione të pavarura (fondi i filmit, fondi i teatrit, fondi i librit apo qendra e librit, qendra e ansambleve, e filarmonisë, e operës etj) kurse ministria të merret ekskluzivisht me politika të larta kulturore, mbi të gjitha, humane

Nga Avni HALIMI

Kush mund ta trondit fuqishëm një pushtet politik të paudhë më shumë se sa elita kulturore, më shumë se sa institucionet dhe shoqatat që merren me kultivimin e identitetit të mirëfilltë kulturor! Pse sot në Maqedoninë e Veriut nuk ka një personalitet të fuqishëm letrar, një aktor të madh, një krijues fjala e të cilit do të kishte peshë të madhe kombëtare! Sepse, të tillët sot janë të shpërndarë nëpër parti, ose, duke qenë nën presionet e mëdha sociale, i nënshtrohen secilit pushtet i cili e ka gjetur mekanizmin e heshtjes së këtyre shtresave elitare përmes "financimit" të projekteve të ndryshme kulturore!

Gjeostrategjia kulturore

Deri më sot, politikat kulturore të qeverive maqedonase mbështeten kryesisht në dy aktivitete prioritare: në gërmime arkeologjike dhe në prezantim të kulturës nacionale maqedonase nëpër vendet e ndryshme të botës. Akoma janë të freskëta politikat nacional-shoviniste të Gruevskit, i cili ia doli të krijojë edhe hartën e gjeostrategjisë kulturore të Maqedonisë së Veriut, e cila kryekëput shkonte në drejtim të përforcimit të "bindjes" se Maqedonia na është shtet një-etnik e një-kulturor. Me këtë "fakt" duhet të bindet edhe bota perëndimore! Ky ishte prioriteti i kësaj politike dhe para këtij prioriteti duhej të përkuleshin e të heshtnin të gjithë ata që merreshin me veprimtari krijuese e, përgjithësisht, kulturore. Heshtja shpaguehej! Qeni me ndonjë kockë nga i zoti i shtëpisë, kulturë-dashësi me ndonjë projekt nga pushtetari...

Më vitin 2006-2007 gërmimet arkeologjike ishin të përqendruara në 5-6 lokalitete në tërë Maqedoninë, më vitin 2008-2009 ky aktivitet u shtri në 16 lokalitete, ndërsa më vitin 2010 u bënë gërmime në 21 lokalitete, kryesisht në Maqedoninë verilindore dhe juglindore. Të gjitha gjërat e gjetura, mbi 300-400 mijë artefakte të zbuluara, në vend se të emërohen si trashëgimi kulturore e shtetit, ato u përvetësuan dhe u quajtën si trashëgimi kulturore maqedonase!

Çfarë peshe kulturore ka një popull me trashëgimi kulturore të vjedhur?! Trashëgimia kulturore në Francë është një nga më të pasurat në botë, por francezët për kulturë, madje të shenjtë, e konsiderojnë përgjigjen shkencore për çdo objekt të cilit nuk ia mohojnë prejardhjen kulturore e etnike. Animi politik kah "kultura ariane" është hyrje në racizëm. Me lashtësi të rrejshme nuk mund të arrihet madhështia kombëtare e të bëhet rreshtimi përkrah popujve me histori sa vetë njerëzimi, përkrah civilizimeve të hershme. Gruevski dhe tajfa e tij "kulturore" sikur bindën se e



kanë arritur atë "pedigree" ndaj dhe, përmes aktiviteteve kulturore jashtë vendit përpjekshin ta bindin botën se vetëm populli i lashtë maqedonas di të bëjë kulturë si populli gjerman, anglez, francez, norvegjez, suedez, spanjoll, italian (po në këtë kohë për në Itali u nis Opera maqedonase në një aktivitet dymujor!!!)

Kjo përpjekje nacional-shoviniste e Gruevskit pati edhe koston e vet financiare! Askush nuk kërkoi llogari për këtë, askush nuk e kuptonte se nga ky aktivitet përfitonin edhe shumë "xhepa patriotikë". Gjatë viteve 2008-2010, qeveria maqedonase, sipas të dhënave të qendrave analitike, kishte shpenzuar afro 100 milionë euro për reklamimin e Maqedonisë ekskluzivisht maqedonase "me vlera të larta antike"!

Strategjia e vrasjes së krijuesve letrar

Para tërë kësaj "politike kulturore" imorale do të heshtin të gjitha shtresat e elitës intelektuale. Aty-këtu mund të vërehej ndonjë protestë nga ndonjë intelektual por, të gjitha ato protesta mbeteshin në suaza të komenteve, analizave e kolumnave gazetareske! Asnjë protestë aktive, asnjë reagim aktiv e i zëshëm i shkrimtarëve, i aktorëve, i piktorëve, i skulptorëve, i muzicentëve, i ansambleve kulturo-artistike! Të gjithë heshtnin, sepse për këtë heshtje paguheshin!

Në rajon dhe më gjerë, veprimtaria botuese tashmë ka marrë karakterin komercial. Shteti, dmth qeveria, mund të subvencionojë vetëm në ato projekte për të cilat mendimi shkencor konsideron se janë me interes të lartë nacional. Vetëm Maqedonia e Veriut i financon botuesit, vetëm në Maqedoninë e Veriut shikon se si shkrimtarët bien në nivelin e botuesit, vetëm

në Maqedoninë e Veriut mund të vërehet se si financohet vdekja e librit! Të gjithë botuesit, shkrimtarët, u kapën për karremin e pushtetit gruevskian dhe aty nisën të bëjnë jetën e parazitit, në vend se të mbeten të dinjitetshëm duke e bërë jetën, nëse jo të disidentit, të paktën jetën e opozitarit, ashtu siç i ka hije kësaj shtrese kulturore karshi politikës të cilitdo pushtet. Një numër i shkrimtarëve dhe i botuesve aktivë nuk bënë zë, sepse frikoheshin nga ndonjë hakmarrje politike, një pjesë e botuesve dhe shkrimtarëve të refuzuar nga programet vjetore kulturore heshtnin, duke shpresuar se me këtë heshtje do të shpërblehen në konkursin e vitit të ardhshëm. Një pjesë tjetër prej tyre pushteti i angazhonte nëpër komisione, këshilla e borde dhe për një shukë lekësh nuk dëshironin t'i prishnin raportet me pushtetin!

Në rajon e më gjerë botimi i librit konsiderohet festë letrare, por edhe sfida për menaxherët të cilët përpiqen që librin ta depërtojnë në çdo bibliotekë shtëpie. Në Maqedoninë e Veriut botuesit dhe shkrimtarët bëjnë hile, botojnë disa ekzemplarë (tani ka makina që të nxjerrin librin edhe në dhjetë ekzemplarë) ndërsa marrin lekë për 1000 ekzemplarë! Pushteti i shihte dhe i toleronte! Të gjithë ishin të kapur në rrjetin e merimangës së pushtetit dhe, të vetëdijshëm se për ndonjë lëvizje eventuale menjëherë pushteti do ta aktivizonin "merimangën" (inspektorët kulturorë, auditin e brendshëm, auditin shtetëror). Prandaj heshtin!

Morali i heshtjes

Shtresat e elitës kulturore në Maqedoninë e Veriut gjithnjë e më shumë po fishken. Ato duan shpëtim dhe, shpëtimi i tyre është vetëm në

themelimin e fondeve si institucione të pavarura (fondi i filmit, fondi i teatrit, fondi i librit apo qendra e librit, qendra e ansambleve, e filarmonisë, e operës etj) kurse ministria të merret ekskluzivisht me politika të larta kulturore, mbi të gjitha, humane. A do të ndodhte kjo venitje, sikur, për shembull, ministria e kulturës të ndante buxhet për "fondin e teatrit" ku do të konkurronin të gjithë teatrot dhe teatër-dashësit! Në botën artistike, pas shkrimtarëve numerikisht më të shumtë janë aktorët! Në botën perëndimore që moti kanë ndryshuar politikat teatrore! Meqë numri i aktorëve është në rritje e sipër, në rritje e sipër janë edhe teatrot të cilat, kryesisht dëshirojnë të funksionojnë si të pavarura! Në teatrot e sotshëm aktori është më i rëndësishëm se drejtori. Vetëm në Maqedoninë e Veriut teatrot funksionojnë për drejtorin. Madhështia e një teatri këtu matet me numrin e premierave dhe, sa më shumë premiera aq më i suksesshëm është drejtori! Funkcioni i teatrit është tkurrur deri në shfaqje të premierës, pas kësaj, nuk është mëkat nëse teatri rri mbyllur për 7-8 muaj në vit! Teatri në fakt është punëtori e aktorit: sa më shumë të punojë aq më shumë do të fitojë! Nuk ka fitim më të madh për aktorin se sa të jetë çdo natë në dërrasat e skenës teatrore ku ai papushuar e kërkon veten, e realizon veten, e gjen përsosmërinë e vet prej aktori të mirëfilltë. Kurse kjo arrihet me përsëritje të shfaqjeve! Përsëritja e shfaqjeve mundëson që çdo aktor të jetë në punë, në detyrë! Teatrot maten me përsëritje të shfaqjeve dhe jo me premiera! Ndaj dhe teatrot duhet të kenë program dhe buxhet për përsëritje të shfaqjeve prej repertorit të krijuar brenda, bie fjala, pesë vjetëve. Premierat pasivizojnë një numër të madh aktorësh, i lënë pa punë, me nga dy-tri vjet e më shumë, ndërsa të papunët duhet të largohen nga organizata! Zaten këtu qëndron edhe morali i heshtjes së një numri shumë të madh të aktorëve, të cilët, tashmë totalisht kanë harruar se ç'do të thotë të aktrosh, të luash në dërrasat e skenës! Heshtin me shpresë se drejtorët partiakë do të kenë mirësinë që t'i angazhojnë në ndonjë premierë, kurse heshtin edhe nga frika se, si të margjinalizuar, nëse pak e ngrenë kokën, do të fluturojnë nga puna!

Politika kulturore në Maqedoninë e Veriut po përjeton krizën më të madhe që ka përjetuar ndonjëherë! Arti dhe kultura janë partizuar deri në përmasa të banales, ndërsa artbërësit dhe kulturëdashësit nuk kanë asgjë të përbashkët me artin dhe kulturën nacionale. Edhe aktiviteti i tyre por edhe heshtja e tyre është në funksion të jetëgjatësisë së pushtetit politik i cili, këtë kontribut, ua shpërblen me ndonjë kockë të tharë. Çfarë mëkat, ë!

SHKRIMTARËT E NDJEJNË PULSIN E KOHËS

Thasë është libër poetik i një rrëfimi shumë personal. E kam quajtur shpella e shpirtit, dhoma e qenies, mitra dhe varri, kthim te vetja, sepse ashtu u shkrua. Nëse poezia është vendi ku rrihet në paqe, shkrimi i tij qe për mua më shumë se vend paqeje, një 'self therapy', 'self-healing', në një kohë kur isha larg vetes, shumë larg

Shkëlzen HALIMI

Blerina Rogova Gaxha (1982) është poete dhe studiuese e letërsisë. Blerina është prezantuar në shumë festivale të letërsisë, duke e përfaqësuar denjësisht letërsinë tonë, si në Gjermani, Austri, Zvicër, Slloveni, Kroaci, Irlandë etj. Poezitë e saja janë përkthyer e botuar në disa gjuhë të huaja (gjermane, angleze, frënge, italiane, sllovene, kroate, greke, rumune, turke, boshnjake, maqedonase). Krijimtaria e saj është prezantuar në antologjinë e poezisë evropiane Europe Grand Tour, 2019. Ka botuar: Gorgonë (poezi, 2009, fitues i Çmimit Kombëtar për poezi, 2010); Kate (poezi, 2013); Format e prozës së Kadaresë (studim, 2015); Ajo vjen nga Lindja (poezi, 2016); Thasë (poezi, 2020, botim i Armagedonit), për të cilin libër u vlerësua me Çmimin kombëtar për veprën më të mirë. Libri i saj i fundit "Vdekja në letërsinë moderne shqipe (Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli)", të botuar nga Instituti Albanologjik, është shpërblyer me çmimin për veprën më të mirë në kritike letrare dhe eseistike 'Ibrahim Rugova', të Ministrisë së Kulturës, për vitin 2021.

HEJZA: Pse u përcaktuat ta shqyrtoni vdekjen në letërsinë moderne shqipe (Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli) dhe në ç'përfundim arritët?

BLERINA: Synimi im ishte trajtimi i njëjës prej temave më filozofike në fushën e letërsisë, gjithnjë e motivuar në fuqinë e vdekjes si fenomen që gjeneron diskutime të pashtershme për esencat letrare. Kërkimi në këtë temë ka të bëjë me njohjen e vdekjes si diçka që na shpërfilllet në jetën reale, dhe letërsia, duke ngritur pyetje për vdekjen, pyet për vetë esencën e qenies, ekzistencën a mosekzistencën e saj; kështu ajo na hapë udhë për t'iu afruar fenomenit të vdekjes dhe për ta imagjinuar atë nga perspektiva të ndryshme.

Në ç'përfundim arrita? Nëse i referohem vetëm asaj që është përmbyllur brenda kapakëve të librit, them se në veprat e autorëve që kam trajtuar do të njihim disa nga skenat më të bukura e më të ndjeshme të vdekjes në letërsinë shqipe: vdekjen e Lokes, vdekjen e Trinës, vdekjen e Nositit, vdekjen e Gjeniut, vdekjen e Tat Tanushit, të Xheladin Beut e vdekjen e Ago Jakupit. Këto krijesa letrare na japin 'konfesionin' e krijueseve rreth vdekjes, reflektimin, frymëzimin, por edhe interpretimin e misterit fundamental të ekzistencës, sipas mënyrës së Mjedjes, Poradecit e Kutelit, si autorë që mendojnë për vdekjen dhe jetojnë e shkruajnë për ne. Kjo letërsi, duke folur hapur për vdekjen, në mënyrë krejt autentike, në secilën vepër zbulon thellësinë filozofike të tekstit letrar.



Përfundimisht, me këto modele të krijimit mbi vdekjen në letërsinë moderne shqipe, hyjmë në botën e madhe të letërsisë, aty ku njeriu dhe poezia e tij shndërrohet në shkrim të pasionit dhe të 'misionit' letrar, duke na hapë udhë të tjera për t'iu njohur misteret e mëdha.

HEJZA: Cila është veçantia e vëllimit të fundit poetik "Thasë", për të cilën Ju kenë thënë se me të sikur e keni rigjetur veten?

BLERINA: Nuk mund ta përcaktoj unë se çfarë e bën të veçantë ose jo librin Thasë. Në aspektin vizuel e bën dizajni me ilustrimet autoriale, ballina e punuar vetë me dorë, zonat gri mes cikleve, përkushtimi dhe dëshira që gjithçka të jetë në një sintezë artistike. Besoj se këto detaje ia shtojnë koloritin semantik, por mbase edhe mund të lexohen si subvariante të shkrimit. Thasë është libër poetik i një rrëfimi

shumë personal. E kam quajtur shpella e shpirtit, dhoma e qenies, mitra dhe varri, kthim te vetja, sepse ashtu u shkrua. Nëse poezia është vendi ku rrihet në paqe, shkrimi i tij qe për mua më shumë se vend paqeje, një 'self therapy', 'self-healing', në një kohë kur isha larg vetes, shumë larg. Një përpjekje për ta thënë qenësoren, dhimbjen e njeriut dhe ringritjen nga errësira.

HEJZA: Pse sot nuk kemi gjenerata krijuesish si dikur, që në viset etnike jashtë atdheut, po shënonin "epoka letrare": gjenerata e Pasluftës së Dytë Botërore, gjenerata e viteve 70-80-90! Ku qëndron problemi: te shkëputja e kontaktit krijues-lexues, te "heshtja krijuese" si pasojë e shkëputjes kohore, e cila kërkon një hedhje të hapit gjigant në krijimtarinë letrare, apo si pasojë e "vdekjes" së kritikës letrare?

BLERINA: Zanafilla është e njëjtë. Letërsinë e bëjnë autorët e veçantë. Por,

shoqëritë shqiptare kanë kaluar kohë të gjatë nëpër kaos. Kryqëzimi i madh i kohërave: lufta, paqja, politika në fillim të viteve 1990 e deri sot në Kosovë; rënia e diktaturës në fillim të 90'tave dhe ndërrimi i sistemeve politike e ideologjike në Shqipëri, tranzicioni që akoma s'ka përfunduar, ka prodhuar një sërë fenomenesh socio-kulturorë. Kryqëzimet e bartën efektin e vet edhe në letërsi. Shkrimtarët e ndjejnë pulsën e kohës, të ndryshimit apo të mosndryshimit, të asaj çfarë solli jeta apo të asaj çfarë i mungon kësaj jete. Pavarësisht kompleksitetit të pyetjes suaj dhe pavarësisht pëlqimit ose jo të konceptit të "brezave letrar", ka dhe mund të ketë autorë që kanë shije të përafërta dhe topika të ngjashme. Dekadave të fundit kemi hasur një letërsi shqipe të ngarkuar me veprimin e traumës historike, siç është topika e post-diktaturës në Shqipëri dhe topika e pasluftës apo lufta dhe trauma e saj në letërsinë shqipe që shkruhet në Kosovë. Madje, kemi shkrimtarë, kryesisht poetë, që erdhën pas këtyre kryqëzimeve në shoqëritë shqiptare, në veprën e të cilëve hasim elemente shumë të ngjashme me të ashtuquajturën gjeneratë e humbur, asaj gjenerate që ëndërroi shumë për lirinë individuale dhe lirinë nacionale, për ta pranuar më pas drejtpërdrejtë disfatën dhe naivitetin e aspiratës së vet si aspiratë e një gjenerate.

HEJZA: A mund të ketë kritikë bashkëkohore letrare në kohën kur po na ngulfat amatorizmi dhe diletantizmi në bërjen e "letërsisë"?

BLERINA: Në kohët moderne, kritika letrare ka nxjerrë statusin e saj si misionare, si një guidë e domosdoshme për letërsinë. Një mision i tillë, duke dashur të përhapë të vërtetën për letërsinë, shpesh e godet mendimin letrar dhe i bën shërbim të keq letërsisë. Prandaj, do të më pëlqente të kishite një qasje të kritikës letrare si provokuese e mendimit dhe e bashkëbisedimit letrar, dhe kuptohet, një kritikë e nivelit profesionist, e shkruar me njerëzillëk e ndershmëri dhe jo një kritikë që shkruhet sipas interesave individuale.

HEJZA: Sipas Jush, jeta letrare e shqiptarëve sot është më e pasur se dikur apo më e varfër?

BLERINA: As ka qenë e pasur dikur, as nuk është e pasur sot.

HEJZA: Në trend sot janë "antologjitë". Sipas disa të dhënave, në këto 30 vjetët e fundit, në të gjitha hapësirat shqiptarë janë sajuar, përpiluar e botuar me qindra e qindra antologji. Pse po ndodh ky fenomen, fatkeqësisht, i shëmtuar?

BLERINA: Me sa kam njohuri dhe



miq jashtë hapësirave shqiptare, i njëjti trend po ndiqet pak a shumë edhe në disa vende të tjera. Ka kërkesa të shumta për një, dy, tri poezi për botime në antologji, e pak për përkthimin e veprës me poezi të një autori. Duket se është e lehtë, një shkrimtar apo një botues që ka miq shkrimtarë/poetë, vë në krye të antologjisë një shkrimtar, fton disa shkrimtarë që ai njeh ose i njohin dhe kështu gatuhet një antologji, e cila me raste di të jetë e bukur, por di të jetë edhe një mish mash poetik.

HEJZA: E bukura, e përkryera, harmonia! Cila është qasja shqiptare ndaj këtyre kategorive filozofike! I pëlqejmë, bëjmë pas tyre, por si sillemi me to?

BLERINA: Di vetëm se na pëlqen të bëjmë filozofin çdo ditë në tavolinat e kafenesë.

HEJZA: A mund të flasim për ngjizjen e evropianizimit të kulturës shqiptare sidomos me politikën paksa më liberale në fushën e artit gjatë periudhës së Mbretit Zog në Shqipëri dhe, shumë më vonë në viset e ngela jashtë shtetit amë. Në çfarë niveli e kemi sot evropianizimin e kulturës shqiptare dhe, në cilat segmente të kulturës mund të haset me qartë ky evropianizim?

BLERINA: Filmi me temë luftën duket se ka depërtuar mirë, edhe letërsia, ajo me temë luftën, ka gjetur dhe vazhdon të gjejë një rrugë. E kaluara, arti që trajton të kaluarën e në veçanti luftën 1998-99 ka ngjallur e vazhdon të ngjallë interes te publiku joshqiptar. Pavarësisht pse jemi një vend i vogël dhe sillemi në një rreth kulture të vogël, kemi artistë të jashtëzakonshëm që krijojnë vepra të bukura, të cilat do të mund t'i ndanim me kulturat tjera.

Por, kjo është një punë që nuk mund të bëhet vetëm individualisht, pa e pasur një krahë të fortë institucional.

HEJZA: Ju keni marrë pjesë nëpër festivale të ndryshme poetike në Evropë. Cili është dallimi mes këtyre festivaleve dhe ato që organizohen në hapësirat shqiptare.

BLERINA: E bukura është se edhe te ne, me këtë i referohem Prishtinës, kanë nisur të mbahen më shumë festivale të letërsisë, disa janë në fillim e ndonjë tjetër tashmë ka një traditë.

Dallimi kryesor mund të jetë konceptimi i një festivali, meqë ai nuk nënkupton vetëm leximet autoriale, por edhe afrimin e autorëve me njeri-tjetrin, afrimin me lexuesin, botuesit, etj, mbase ju mungon interaktiviteti e jo rrallë edhe serioziteti. Sigurisht se festivalet e letërsisë do të ishin më të bukur nëse organizatorët do të ishin më seriozë, më të guximshëm e me vizion të qartë, më shumë punë e përkushtim, por esenciale është edhe që këto organizime financiarisht të përkrahen më shumë.

HEJZA: Është një fakt i pamohueshëm. Sot, ambientin ton letrar e karakterizojnë "kruzhoqet" letrare, provincializmi, amatorizmi, abuzimi, papërgjegjësia e kështu me radhë. Pse ndodh kjo dhe kur do të pasojë reagimi institucional për ta kthyer këtë ambient në binaret e vërteta?

BLERINA: Nuk besoj dhe nuk pres në një reagim institucional për ta kthyer ambientin tonë letrar në binar. As që do të ndodhë dhe gjërat mund të bëhen akoma më të tmerrshme. Uroj vetëm që njeriu jonë të vetëdijesohet, ta çmojë e ta respektoj atë që ka vlerë, të mësohet të mos paragjykojë, të mos shkelë, të mos injorojë.



foto: Ridvan Slivova ©

Iku edhe Nikollë Spathari


NJERIU QË KURRË NUK E TRADHËTOI POEZINË

I papërtuar dhe gjithmonë në kërkim të së bukures në art, i padëshirueshëm për skotën e mediokërve dhe sharlatanëve të letërsisë, ai diti të gdhendë me dinjitet emrin e tij në fushën e letrave

Agim BAJRAMI

Në sallat dhe tryezat e diskutimeve tona letrare, krahas shumë miqve dhe kolegëve tanë të munguar, do të ndihet edhe mungesa e zërit dhe fjalës së mençur të poetit dhe publicistit të njohur, Nikollë Spathari. Ikja e tij e papritur dhe e paparalajmëruar në këtë verë me ngjarje dhe trille shirash, është një lajm i trishtë jo vetëm për familjen, klubin e shkrimtarëve dhe poetëve durrsakë (në krye të cilit ai dha kontributin e tij si kryetar përreth 14 vite), por edhe për lexuesit dhe dashamirësit e letërsisë ngado. Do na mungojnë vargjet plot jetë e sharm të veçantë të poezive të tij lirike, të cilat ai dinte t'i përcillte gjithë energji dhe pasion tek lexuesit, do ndjejmë mall edhe për vargjet plot epicitet dhe tingull lahute të "Lahutës së Malcisë" së Fishtës, të cilat ai si rrallëkush tjetër i kishte mësuar përmendesh që në fëmijëri nga priftërinjtë e zonës dhe i interpretonte me zell. Autori i librit të mrekullueshëm studimor "Malësia e madhe, ashtu siç e njoha unë" dhe i shumë librave të tjerë studimorë si "Në këngë është dhe historia" apo i atij për "At Benedikt Demën", ai diti të spikaste mes dhjetëra studiuesve dhe akademikëve të tjerë të kësaj fushe, si për analizat dhe hulumtimet e thella me karakter shkencor, ashtu dhe për stilin e veçantë bindës dhe shterues në këtë lëmë. Përvoja e tij e gjatë si mësues dhe gazetar në fshatrat e Malësisë së Madhe dhe kontakti me lëndën e begatë historike dhe etnografike të kësaj zone, ishin një bazë e shëndoshë dhe një ndihmë e paçmuar për studimet e tij. Nikolla nuk lindi me stof studiuesi, por u bë në sajë të rrezatimit të pazakontë të etnosit të zonës që i përkiste. Kam lexuar dhjetëra opinione studiuesish dhe profesionistësh të njohur të kësaj fushe për librin e tij studimor "Malësia e Madhe, siç e njoha unë" dhe kam ndier tek të gjithë ata, duke përfshirë prof Rexhep Qosja, prof Jup Kastrati, Ahmet Osja dhe prof Begzad Balilaj etj., krahas vlerësimeve të larta për punën, edhe një lloj habie dhe adhurimi intelektual. Karakteristike në këto libra mbetet ndërthurja e elementit letrar me atë historik, thellësia hulumtuese dhe puna me arkivin. Talenti i tij si poet dhe shkrimtar e ndihmoi atë të shmangë me sa të mundë të folurin e ftohtë dhe te ngarkuar akademik, duke e zëvendësuar atë me të folurën letrare tepër të zhdërvjelltë dhe të figurshme. Nikolla lindi në Malësinë e Madhe për t'i vjelë asaj jehonën e legjendave dhe baladave

epike, këngët majë krahi dhe epin e kreshnikëve. Ai u ngjiz prej tyre dhe u dashurua përjetësisht me to për të mbetur tërë jetën zëri i parë dhe zëdhënësi i tyre më besnik. Edhe pse u largua prej andej dhe u transferua në Durrës, buzë detit, profili i tij të kujtonte një copë shkëmb arratisur nga mali së bashku me eposin e tij. Erudicioni i tij binte në sy menjëherë. Mjaftonte të hapje një bisedë, apo të hidhje një temë për debat dhe fjala e tij zinte vend. I papërtuar dhe gjithmonë në kërkim të së bukures në art, i padëshirueshëm për skotën e mediokërve dhe sharlatanëve të letërsisë, ai diti të gdhendë me dinjitet emrin e tij në fushën e letrave. Ndërsa shkruaj këto radhë, risjell në mendje veprimtaritë e shumta letrare në Durrës dhe jashtë tij, revistën "Vegime letrare", që ai e ideoi dhe e drejtoi me sukses për një dekadë, takimet dhe udhëtimet tona të herëpashershme drejt qyteteve të shumtë shqiptare, drejt sofrës magjike të poezisë dhe njerëzve të fjalës së bukur. Vëllimet e tij me poezi për të rritur, ku spikat veçanërisht libri "S'iki dot nga kjo vjeshtë", karakterizohen nga befasitë e shumta poetike dhe gjuhën metaforike. Jo më kot shumë nga këto poezi janë nderuar me çmime të ndryshme në Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi. Të njëjtat konsiderata mund të rreshtojmë edhe për kontributin e tij në fushën e letërsisë për fëmijë. Poema e tij "Një shtyllë elektrike" dhe romani "Djemtë e dikurshëm" janë trajtuar shpesh nga kritika letrare e kohës jo vetëm për forcën e vargut, por edhe për figurat interesante dhe kaq afër psikologjisë së lexuesve të vegjël. Mbaj mend emocionin dhe duartrokitjet e nxehta që shkaktuan vargjet e poemës së tij, "Flamurtarët e Deçiçit", në sallën e Pallatit të kulturës në Tuz të Malit të Zi, në kuadër të festave të 100 vjetorit të pavarësisë. Disa nga poezitë e tij bëjnë pjesë edhe në antologjinë kombëtare të letërsisë për fëmijë, përgatitur nga poeti dhe redaktori i njohur Pandeli Koçi. Nikolla dhe poezia u deshën pa kushte dhe kurrë nuk e tradhtuan njeri tjetrin. Edhe pse vitet e fundit shëndeti i tij u rëndua, vargu poetik dhe humori i tij mbetën përsëri në kuota të larta. Mik i vjetër me Skënder Drinin, Frederik Reshpien etj, ai diti të marrë prej tyre anët më të mira, duke u kthyer kësaj në një lloj enciklopedie lëvizëse. Nikollë Spathari shkoi drejt tyre, duke braktisur botën e zakonshme fizike, për t'u bërë kësaj pjesë e përhershme e kujtesës sonë letrare, asaj kujtese që jo gjithkujt i përket...



BUKURIA E PAVARUR

Kur bëhej fjalë për analizën e së bukurës, Kanti vë në dukje se të pëlqesh të bukurën është aspekt sasior, në një mënyrë përgjithësisht të vlefshme, në aspektin e cilësisë, pa interes, në aspektin e marrëdhënies si synim subjektiv dhe në termat e modalitetit si domosdoshmëri

Nga Metin ZETI

Shpirti harmonizohet bukur me sublimen në atë që të dyja, edhe subjekti edhe objekti, janë vetvetja që u pëlqen. Ata gjithashtu pajtohen bukur dhe sublimisht në atë që as njëri as tjetri nuk presupozon ndonjë gjykim shqisor, as ndonjë gjykim logjik-determinist, por gjykimin të reflektimit. Ky pëlqim nuk lidhet me një ndjenjë të tillë si ndjenja e këndshmerisë, as me ndonjë koncept të veçantë, siç është pëlqimi që shkakton atë që është e mirë, por lidhet me përfaqësimin e pastër ose me fuqinë e përfaqësimit, ku fuqia e përfaqësimit ose imagjinata vërehet në një perceptim të caktuar, sipas fuqisë së koncepteve të arsyes ose mendjes. Kjo është arsyeja pse të dy llojet e gjykimeve, edhe ai i shijes edhe ai i arsyes, janë gjykime individuale, por gjithsesi të tilla që e reklamojnë veten si të vlefshme universale për çdo subjekt (edhe pse pretendojnë vetëm se ndjejnë kënaqësi dhe nuk e njohin temën).

Bukuria e pavarur e natyrës

Në të njëjtën kohë, ekzistojnë dallime midis këtyre dy llojeve të gjykimeve. E bukura natyrale i referohet asaj forme të objektit që konsiston në kufizimin; megjithatë, sublimja mund të gjendet edhe në ndonjë objekt të paformuar, nëse mbi të ose rreth tij imagjinohet pakufi, e megjithatë tërësia e saj shtohet në mendje, kështu që pamja e bukur kuptohet si shfaqja e ndonjë koncepti të pacaktuar të arsyes, dhe sublimja si shfaqja e disa koncepteve të pacaktuara të mendjes. Prandaj, në rastin e së bukurës, pëlqimi kombinohet me paraqitjen e cilësisë, dhe në rastin e sublimes me paraqitjen e sasisë, dhe pëlqimi që shkakton sublimen është i ndryshëm nga pëlqimi që shkakton të bukurën: ashtu si pëlqimi i së bukurës mbart drejtpërdrejt në vetvete një ndjenjë të përsosjes së jetës, ndjenja e sublimes përfaqëson një kënaqësi që lind vetëm në mënyrë indirekte, duke u prodhuar nga ndjenja e një frenimi momental të forcave jetësore dhe derdhja e tyre që ndodh menjëherë më pas. Duke qenë se objekti tërheq dhe sprapsin njëkohësisht shpirtin, të pëlqesh sublimen nuk përmban aq kënaqësi pozitive sa admirim dhe respekt, ndaj meriton të quhet kënaqësi negative.

Ndërsa e bukura në natyrë (bukuria e pavarur) mbart në vetvete një qëllimshmëri të formës së saj, si rezultat i së cilës objekti është thjesht i destinuar për fuqinë tonë të gjykimin, dhe kështu përbën një objekt pëlqimi në vetvete, përkundrazi, atë që ngjall tek ne një ndjenjë të sublimes, mund për fuqinë tonë e të gjykuarit të duket e papërshtatshme, dhe për imagjinatën si të thuash e dhunshme, por ajo konsiderohet sikur të ishte edhe më e lartësuar. Nuk është e nevojshme të thuhet se objekti është sublim, por se ai është i përshtatshëm për të shfaqur njëfarë lartësie, që mund të haset në shpirt, pasi sublimja në kuptimin e vërtetë nuk mund të përmbahet në asnjë formë kuptimi, por qëndron vetëm në lidhje me idetë e mendjes. Bukuria e pavarur e natyrës na zbulon një teknikë të natyrës që e paraqet atë si një sistem të bazuar mbi ligjet, parimi i të cilave nuk gjendet askund në ne, sipas fuqisë racionale, përkatësisht sipas fuqisë së një qëllimshmërie që i referohet ushtrimit të fuqisë së gjykimin në lidhje me dukuritë, kështu që dukuritë duhet të gjykojnë jo vetëm si i përkasin natyrës në mekanizmin e saj jo-qëllimtar, por edhe si diçka analoge me artin. Ajo bukuri e pavarur natyrore nuk zgjeron njohuritë tona për objektet natyrore, por zgjeron nocionin tonë për natyrën, nocionin tonë për natyrën si një mekanizëm i thjeshtë, në nocionin e asaj

natyre si art; ndërsa për natyrën e bukur duhet të kërkojmë ndonjë bazë jashtë nesh, bazën për sublimen mund ta kërkojmë vetëm brenda nesh dhe në atë mënyrë të menduarit që sjell sublimitet në idenë e natyrës.

Kur bëhej fjalë për analizën e së bukurës, Kanti vë në dukje se të pëlqesh të bukurën është aspekt sasior, në një mënyrë përgjithësisht të vlefshme, në aspektin e cilësisë, pa interes, në aspektin e marrëdhënies si synim subjektiv dhe në termat e modalitetit si domosdoshmëri. Në analizën e sublimes, Kanti beson se duhet

sesa kur thuhet se është absolutisht e madhe. Absolutisht e madhe është ajo që është e madhe pavarësisht nga çdo krahasim, dhe për këtë arsye sublime është ajo me të cilën çdo gjë tjetër bëhet e vogël në krahasim. Kështu tregohet se asgjë nuk mund të ekzistojë në natyrë, sado e madhe ta vlerësojmë atë, e cila, e parë në një relacion tjetër, nuk mund të zhvlerësohet në infinitiminale. Nga ana tjetër, Kanti nisat nga fakti se sublime nuk duhet të quhet objekt, por më tepër një gjendje shpirtërore që shkaktohet nga një paraqitje e caktuar që ka të bëjë me fuqinë reflektive të gjykim-

isht (për subjektin gjykues) nuk është e mundur asnjë masë më e madhe, atëherë ky më i madhi estetik mbart me vete idenë e sublimes dhe prodhon atë emocion që nuk është në gjendje të mos shkakton ndonjë vlerësim matematikor të madhësive me anë të numrave (përveç nëse ajo masë bazë estetike ruhet gjallërisht në imagjinatë), sepse vlerësimi matematikor i madhësive me anë të numrave tregon gjithmonë vetëm madhësinë relative, gjithmonë duke e krahasuar me përmasa të tjera të të njëjtit lloj, ndërsa vlerësimi estetik i përmasave tregon madhësinë në kuptimin absolut, nëse shpirti është në gjendje ta kuptojë atë në një perceptim.

Duke marrë intuitivisht një sasi kuantike në imagjinatë në mënyrë që kjo kuantë të mund të përdoret si masë ose si njësi për të vlerësuar madhësinë duke përdorur numrat, për këtë nevojiten dy veprime të kësaj fuqie: kapja (apprehensio) dhe të kuptuarit (comprehensio aethetica). Sa i përket kapjes, nuk ka vështirësi, sepse me të mund të shkosh në pafundësi; por, kapja bëhet gjithnjë e më e vështirë nëse kapja shkon më tej, dhe së shpejti arrin maksimumin e saj, përkatësisht, në masën bazë estetikisht më të madhe për vlerësimin e madhësive. Nëse kapja ka arritur një pikë të tillë që ato paraqitje të pjeshme të perceptimit shqisor që u kapën fillimisht tashmë fillojnë të zbehen në imagjinatë, ndërsa imagjinata vazhdon të kuptojë paraqitjet e tjera të pjeshme, atëherë ajo humbet aq shumë nga njëra anë sa fiton në tjetër, dhe në kapje ka diçka më të madhe, pasi, ajo, nuk është në gjendje ta kapërcëjë mendjemadhësinë. Kjo është arsyeja pse ne nuk duhet të afrohem shumë ekstrem me Zotin, ashtu siç nuk mund të jemi shumë larg prej Tij, që të mund të përjetojmë eksitim e shkaktohet nga Madhështia e Tij. Nga një distancë e madhe, Zoti do të shihet në mënyrë të paqartë, dhe nëse afrohem shumë, nuk do ta kapim brenda një ore, por pamja do të lëvizë nga baza në majë, kështu që diçka e tillë do të marrë gjithmonë pak kohë dhe gjatë kësaj kohe, cilësitë dhe emrat e Tij janë gjithmonë pjesërisht ato shuhet para se imagjinata të ketë kapur pjesët e saj të fundit dhe kapja e tyre nuk është kurrë e plotë.

I frikësuar nuk është në gjendje të gjykojë natyrën sublime

Vetë natyra është sublime në kontekst të dukurive të saj, perceptimi i të cilave mbart me vete idenë e pafundësisë së saj. Për sa i përket vlerësimin matematikor të sasive, imagjinata i takon çdo subjekti dhe është në gjendje të prodhojë një masë të mjaftueshme për atë vlerësim matematikor; vlerësimi estetik i madhësive duhet të jetë ai në të cilin njeriu ndjen një përpjekje drejt ngjeshjes që tejkalon aftësinë e imagjinatës, që kapja progresive përfshin një tërësi perceptimi dhe në të njëjtën kohë percepton pamjaftueshmërinë në përparimin e pakufishëm të fuqisë për të krijuar një masë bazë me përpjekje më të vogël të mendjes, të përshtatshme për vlerësimin e madhësive dhe për ta përdorur atë për atë vlerësim të madhësisë. Masa e parë e pandryshueshme bazë e natyrës është tërësia e saj absolute, e cila pranë saj si fenomen paraqet pafundësinë e saj të përmbledhur. Duke qenë se kjo masë bazë është një koncept vetëkontradiktore që tejkalon në madhësi çdo masë të shqisave, do të thotë se nuk është objekti që vlerësohet si sublim, por disponimi mendor apo shpirtnor në gjykimin e tij.

Në ndryshim nga ai matematikor, ekziston edhe një kuptim dinamik i sublimes. Forca përfaqëson një fuqi që kapërcen pengesa të mëdha. E njëjta forcë quhet fuqi kur kapërcen rezistencën e asaj që vetë



marrë parasysh një ndarje që nuk ishte e nevojshme në analizën e së bukurës: ai bën dallimin midis sublimes matematikore dhe asaj dinamike. Kjo sepse ndjenja e sublimes mbart brenda vetes si karakter një ngacmim shpirtëror që lidhet me gjykimin e objektit, ndërsa në të bukurën shija presupozon dhe e mban shpirtin në soditje paqësore.

Vlerësimi i madhësisë me konceptet e numrave

Ne e quajmë sublime atë që është thjesht (absolutisht) e madhe. Por të qenit i madh dhe të shfaqës madhësi janë koncepte krejtësisht të ndryshme (magnitudoj quantities). Po kështu, kur thuhet se diçka është thjesht (më e thjeshtuar) e madhe, është gjithashtu diçka krejtësisht e ndryshme

it, dhe për këtë arsye thotë se, ajo që është sublime është ajo që, edhe vetëm duke qenë në gjendje të imagjinosh, tregon fuqinë e shpirtit që tejkalon çdo masë të shqisave. Vlerësimi i madhësisë me konceptet e numrave (ose shenjat e tyre në algjebër) është matematikor, dhe vlerësimi i tyre në perceptimin e pastër (me masën e shikimit) është estetik. Çdo gjykim për madhësinë e një objekti në natyrë është, në fund të fundit, estetik (përcaktohet subjektivisht dhe jo objektivisht), dhe për sa i përket vlerësimin matematikor të madhësive, nuk ka gjë më të madhe për një vlerësim të tillë, sepse rregulli i numrave shtrihet në pafundësi; por, për sa i përket vlerësimin estetik të madhësisë, sigurisht që ka diçka më të madhe për të; dhe për këtë më të madhin estetik mund të thuhet: nëse gjykohet si masë absolute, se sa subjektiv-

E BUKURA NATYRORE

Ekzistojnë dy paradigma teorike të estetikës pozitive: paradigma teorike individualiste dhe paradigma teorike holistike

Afrim REXHEPI

Sipas disa përcaktimeve teorike, estetika pozitive në esencë e pranon idenë, gjithçka që ekziston në natyrë është e bukur. E shëmtuara në natyrë shfaqet kur natyra është nën ndikimin destruktiv të njeriut. Pra, vlera e estetikës pozitive qëndron në funksionin e përforsimit të vetëdijes ekologjike për natyrën. Themeluesi i estetikës pozitive, Alen Karlson, definon: "Ambienti natyror, deri në atë shkallë sa nuk është i prekur nga njeriu, kryesisht ka kualitet estetik pozitiv. Natyra është e bukur dhe e madhërishme, është delikate dhe sublime, është unitare, intensive, e shumëllojshme, simetrike dhe harmonike, pastaj është edhe ironike, e mërziqshme, kaotike. E gjithë natyra, në esencë, estetikisht është e bukur". (Carlson, 1984: 5-34.)

Ekzistojnë dy paradigma teorike të estetikës pozitive: paradigma teorike individualiste dhe paradigma teorike holistike. Paradigma teorike individualiste e estetikës pozitive tregon në faktin që kur raporti ynë me realitetin është negativ, gjegjësisht kur format (organizmat) nga natyra janë të deformuara, të shëmtuara dhe groteske, atëherë përmes aktit të perceptimit, tek ne shkaktojnë energji negative estetike. Në fakt, ky është edhe qëndrimi i individualistit i Butit, me të cilin nuk pajtohet Emily Bradley. Bradley mendon në faktin që një përcaktim i tillë teorik është i gabuar pasi është idealist. Duke u bazuar në estetikën e Kantit, konkretisht në dallimin midis gjykimit estetik dhe gjykimit moral, Bradley mendon në faktin që e bukura ndodhet midis unitetit të formave të natyrës dhe se të bukurën, e shijojmë. Pra, e bukura gjeneron efekte pozitive estetike që arrihet përmes rinjohjes së shumëllojshmërisë të situatave dhe vlerave estetike në natyrë. Është e nevojshme që me seriozitetin më të thellë të dallohet e bukura në kuadër të shumëllojshmërisë së formave të natyrës sepse kualitetet estetike të natyrës janë shumë të thella. Në ligjëratat e saj për të bukurën në natyrë, Bradley bën dallim midis të bukurës natyrore dhe të bukurës estetike. Për Bradlyn, e bukura natyrore është nocion më i gjerë në të cilën qëndrojnë të lidhura kualitetet estetike dhe joestetike si: e bukura, harmonia, sublimja, lumturia, gëzimi, tronditjet negative, tmerrri i këndshëm, e shëmtuara, disharmonia, shkatërrimi etj. Kualitetet pararendëse estetike dhe joestetike, krijojnë estetikën ekologjike në të cilën nuk eliminohen kualitetet estetike negative, por e kundërta, e gjithë natyra është e bukur dhe mahnitshme bashkë me egërsirën në brendi. Nëse do t'i eliminonim vlerat negative estetike nga përvoja jonë e shijes me natyrën, atëherë përvoja jonë, ndjeshëm do të dobësohet në dobi të estetikës ekologjike. Megjithatë, për Bradlyn, nuk mjafton fakti që të shijohet uniteti i formave të natyrës por e bukura duhet të shfaqet në natyrë. Pragmatizmi i të bukurës, është formula përmes së cilës Bradley e ul të bukurën midis natyrës edhe atë si impuls pozitiv dhe pragmatik në nxitjen e vetëdijes ekologjike gjegjësisht të moralit për natyrën. Tendencën e saj individualiste, Bradley e shpreh përmes definicionit në vijim: "Mendoj që duhet t'i kthehemi perceptonit të gjërave të bukura në natyrë. Lejleku me peshkun në gojë, në fluturim, duket i madhërishëm, por nga pikëvështrimi ekologjik, një akt i tillë është tragjik. Natyra në vete, është e bukur, por edhe tragjike. Përmes shpirtit pozitiv, Estetika duhet ta ngrys moralin për të bukurën në



natyrë". (Bradly, 2015)

Sipas teoricienëve, paradigma teorike individualiste e estetikës pozitive, i rekomandon referencat në vijim: 1. Estetika pozitive duhet ta funksionalizojë mendimin që estetika negative në natyrë, është e mundur; 2. Estetika pozitive nuk duhet të praktikohet në ndonjë pjesë tjetër të botës, inkuadruar këtu edhe botën e artit dhe të mjedisit ku jeton njeriu, sepse natyra është bukur e veçantë; 3. Estetika pozitive është reale dhe pragmatike në raport me natyrën, e jo konceptuale dhe teorike; 4. Estetika pozitive është doktrinë e cila përmes estetikës ekologjike ose narracionit, bëhet e dobishme në ruajtjen e pastërtisë së natyrës.

Përfaqësuesi tipik i paradigmës holistike të estetikës pozitive është Alen Karlsoni, i cili estetikën pozitive e definon përmes idesë që natyra në plotnë e vet është harmonike dhe e bukur, dhe se vendet e paprekura të natyrës nga njeriu funksionojnë përmes rendit dhe harmonisë, gjegjësisht janë të bukura dhe krejt pozitive. Sipas Karlsonit, gjatë perceptimit dhe vlerësimit të natyrës, është e nevojshme të krijohet "model i përcaktuar i hapësirës natyrore". Në kontekst, ne duhet ta vlerësojmë apo ta perceptojmë natyrën në ndritësimin e vet përmes kognitivizmit shkencor. Prurjet e reja nga gjeologjia, biologjia dhe ekologjia, vetëm na ndihmojnë në zgjerimin dhe thellimin e njohjeve tona dhe mundësive tona për natyrën. Nëse duam ta vlerësojmë ndonjë balenë, atë duhet ta bëjmë përmes kategorisë së "sisorëve", e jo përmes kategorisë së "peshqve" apo të

fjala, turistët duke shëtitur në natyrë, vërejnë drerin e qelbosur, tek ata do të shkaktohet efekt estetik negativ, por nëse e zgjerojmë diapazonin e të menduarit, do t'i njohim kategoritë plotësuese për interpretim. Trupi i qelbur i drerit, riciklohet, shndërrohet në ushqim mizash, e mizat në ushqim për zogjtë. Selektimi natyror, rezulton me drerin e dobishëm për gjeneratat që vijnë. E gërditshme e momentit, është vetëm një imazh i momentit nga shumë imazhe lëvizëse. Konfrontimi i vlerave, sipas logjikës simbioze, nuk është e gërditshme, por e bukur. Bota nuk është një botë si Uolt Dizni, por një botë me një bukuri të errët. Në një botë të tillë, vdekja është hija e lindjes". (Hettinger, 2012:18)

Siç edhe mund të vërehet më lartë, estetika pozitive ka për tendencë të argumentojë tezën që natyra, në thelbin e saj, është e bukur. Tendencat e tilla teorike, konstruksione të tilla, ndodhen në thelbin e themeluesit të estetikës pozitive Alen Karlson. Duke mos e bërë dallimin e duhur midis perceptimit estetik dhe artistik të natyrës, Karlsoni tregoi në faktin që kriteret shkencore, estetikisht e kuptimësojnë natyrën. Jo vetëm që hulumtimet shkencore estetikisht e kuptimësojnë natyrën përmes shkëlqimit të harmonisë, rendit, baraspeshës, por shkenca argumenton faktin që natyra, brenda vetes, i posedon kualitetet estetike. Shkenca nuk i vendos kualitetet estetike në natyrë, por duke e hulumtuar natyrën, i zbulon kualitetet estetike midis natyrës. "Në këtë mënyrë, shkenca tregon që natyra, në esencë, estetikisht është e bukur. Pra, shkenca, jo vetëm që bën që natyra estetikisht të duket e bukur, por përmes funksionalitetit të saj preciz, tregon në faktin që natyra, në thelbin e saj, estetikisht është e bukur". (Carlson, 2000: 97)

Megjithatë, ideja për një estetikë pozitive është më e vjetër, e gjejmë në principet impulsive filozofike të Lajbnic-it, të quajtura monada. Përmes tezave të tij për monadat, Lajbnici paralajmëroi një version brilant të estetikës pozitive. Sipas tij, "Monada është substancë e thjeshtë që hyn në strukturën e substancave të ndërlikuara; Monada është substancë e thjeshtë, pa elemente përbërëse; Monadat janë atomet e vërteta të natyrës, me një fjalë, elemente përbërëse të gjërave; Monadat nuk kanë dalje përmes të cilave mund të hyhet a dilet; Monadat posedojnë elemente të dalluara, secila dallohet nga tjetra si rezultat i ndryshimeve të brendshme; Shumësia e zotit, ekzistojnë pafundësisht univeerse që dallojnë nga shkallët e së përkryerës, bota jonë, me gjasë, është bota më e përkryer". (Lajbnic, 2002: 93 - 123)

Citati pararendës, tregon në faktin që monadat janë substanca të thjeshta dhe të pazbërthyer. Janë jomateriale, sepse nuk janë të përbëra, prandaj nuk mund të zbërthehen në njësi më të imta. Monadat janë substanca shpirtërore, univeerse të veçanta dhe perfekte në imanencë. Dallohen njëra nga tjetra dhe përmes dallimit funksionojnë sipas logjikës së vazhdimësisë perfekte. Monadat bëhen funksionale sipas ligjit të identitetit, kontinuitetit dhe forcës. Monadat nuk veprojnë njëra ndaj tjetrës, ata janë botëra paralele, të vendosura sipas ndonjë force a inercioni, përmes së cilës krijohet bota. Mbi të gjitha monadat, ekziston monada absolute, monada Zoti që krijon harmoninë perfekte si botë më e përsosur nga të gjitha botërat e mundshme. Që do të

thotë se ideja e Lajbnicit bazohet në konceptin e botës si botë e monadave, duke e vulosur idenë që bota në plotninë e vet, është sistem i përcaktuar i harmonisë perfekte. Edhe pse Lajbnici dhe Karlsoni, në kuptimin e natyrës, dallohen në faktin që njëri shpjegon përmes procedurës informative matematikore, e tjetri përmes procedurës historike në klasifikimin e kategorive të natyrës, së bashku e definojnë natyrën si kontinuum i përsosur, njëri përmes analogjisë së substancave të thjeshta – monadat, e tjetri përmes ligjit të palingenezës, sipas analogjisë “Saturni i han fëmijët e vet”. Që do të thotë se sistemi a struktura e botës empirike, është në funksion të idesë së bukurisë perfekte dhe harmonisë universale.

Pavarësisht nga pozicioni metodologjik, Lajbnici dhe Karlsoni janë të bindur që shkenca i zbulon vlerat objektive të bukurisë natyrore, si rendi dhe harmonia pozitive. Lajbnici shkron më tutje duke pohuar që zbulimet e bukurive natyrore,

na japin të drejtën që më shumë ta respektojmë krijuesin e tyre absolut. Sa më shumë që shkenca i zbulon dhe i ndritëson rendin dhe harmoninë pozitive të natyrës, aq më shumë do të besojmë në projeksionet harmonike të natyrës. Sipas disa teoricienëve, estetika pozitive e Lajbnicit, është më e thellë dhe më e përgjithshme se bindjet e Karlsonit, sepse në raport me fenomenet e shëmtuara të natyrës, Karlsoni pranon faktin që estetika e tij pozitive nuk ka të bëjë me gjërat e shëmtuara apo deformimet e formave (organizmave) në natyrë. Një qëndrim i tillë teorik i Karlsonit, vetëm e përkufizon paradigmen e tij të estetikës pozitive. Nga ana tjetër, përmes teologjisë racionale, Lajbnici ofron zgjidhje më të mirë. Fenomenet e shëmtuara në natyrë, ndodhin derisa ne do të mësohemi që të pozicionohemi drejt. Në natyrë, nuk ekzistojnë fenomene të shëmtuara, e gjithë natyra, në plotninë e vet, është harmonike dhe pozitive, apo nëse ato ekzistojnë, është rezultat i njeriut i cili e

deformon harmoninë perfekte. Nëse qëndrojmë në tokë, dhe nga ky pozicion e perceptojmë natyrën, do të vërejmë fenomene negative dhe forma të deformuara, por, nëse pozicionohemi në diell dhe nga ajo pozitë e perceptojmë tokën në lëvizjen e saj të përhershme rreth diellit, atëherë e kemi perceptuar harmoninë universale, ligjin absolut, monadën absolute – Zoti. Logjika dekonstruktive, do t'i lidhte shkencat e natyrës me teologjinë racionale, në funksion të një estetikë pozitive të natyrës.

Punimi i vlerësoi dy paradigme të estetikës pozitive. Njëra paradigme i takon Lajbnicit dhe Karlsonit, e tjetra i takon Emily Bradlyt. Ajo që në thelb i dallon paradigmat e estetikës pozitive, është ekzistimi i formave të shëmtuara dhe groteske të natyrës. Derisa paradigma e parë e deformimit, groteskut dhe tragjikes së formave të ndryshme të natyrës, i transformon përmes kategorisë ndryshim – natyra është harmoni absolute, e shëmtuara është

kategori kaluese në kuadër të harmonisë absolute, paradigma e dytë, nuk e mohon praninë e formave (organizmave) në deformim, e formave groteske dhe tragjike e formave të njëjta. Me interes është procedimi analitik i Bradlyt për estetikën pozitive, sepse tragjiken në natyrë e përcakton në favor të funksionalitetit estetik. Sipas Bradlyt, ne nuk mund që pozitivisht ta shijojmë bukurinë natyrore, nëse nuk ekziston kontrasti i saj, e shëmtuara. Pra, në estetikë, kontrasti shkakton përjetime të thella estetike. Ekzistimi i natyrës pa të shëmtuarën dhe fenomenet e shëmtuara, estetiki është më pak funksionale. Përmes lojës në kontrast e bukur – e shëmtuar, natyra duket më e bukur dhe më interesante, jo vetëm për estetët por edhe për kognitivistët. Në fakt, ky është edhe qëllimi esencial i estetikës pozitive, të zbulohet e bukura natyrore, të shijohet harmonia e saj perfekte, duke e nxitur në vazhdimësi vetëdijjen ekologjike për natyrën.

Interpretime

GJUHA SI MËNYRË MBIJETESE


(“Gjuha e burgut” te libri “Jetë burgu” të Fatos Lubonjës)

Bukurie MUSTAFA

Ligjërimi gjuhësor i shqipes njehe stile të ndryshme të të shprehurit, siç janë “gjuha e grave”, “gjuha e fëmijëve” e të tjera, të cilat shndërrohen në koncepte kuptimore vetëm për një grup të caktuar njerëzish. Në këtë kontekst, autori Fatos Lubonja, ish i burgosur politik, arrin që në librin e tij “Jetë burgu” (Skanderbeg Books, 2021), të shfaqë një formë tjetër komunikimi të këtij mjedisi të izoluar dhe të mbyllur për botën e jashtme. Në burg, leksemat përfitojnë një vlerë të re kuptimore, duke u dalluar nga fjalët e jetës së lirë, siç i quan Lubonja. Për të kuptuar këtë gjuhë, autorit i nevojitet një kohë e gjatë qëndrimi brenda burgut edhe ai vetë e thotë: “Me kalimin e viteve vura re se zhargoni i burgut kishte shumë fjalë që nuk i kisha dëgjuar ndonjëherë më parë të lindura nga nevoja për të shprehur gjendje që i përkisnin vetëm asaj bote”. Burgosja e Lubonjës, i mundësoi atij që të njihet më për së afërmi me një mënyrë tjetër të komunikimit, duke vërejtur, se të kuptuarit e drejtë e fjalëve “të koduara”, kishte të bëjë edhe me mbijetesën në një mjedis të krimit dhe ndëshkimit.

Personazhet e Lubonjës janë të burgosur që kanë vetëm emra pa mbiemra, e disa nga këta mbajnë nofka, e që kishin të bëjnë me ndonjë të ngjarë nga jeta e tyre dhe e kaluara. Një nga ata ishte Ferit Lopa dhe emri i tij, gjithnjë shoqërohej nga shprehja dora jonë. Kjo ishte edhe shprehja e parë, që e kishte dëgjuar, e që siç thotë ai, lidhej me persona me sjellje të caktuar. Autori sqaron: “Emrin “dora jonë”, në kuptimin e bërjes pjesë në të njëjtin taraf, e që origjinën e kishte nga evgjitët që e përdornin për të identifikuar njëri-tjetrin”.

Lubonja dallon përdorimin e metonimisë në kuptimin e ndryshuar të ndonjë fjale të njohur, e që krijohet brenda burgut, e pastaj përdoret edhe nga të tjerët. Metonimia më e njohur ishte fjala “mishi”, që përdoret për sjelljet e reja të autoburgut, përkatësisht përdorshin për të emërtuar personat e rinj, që futeshin në burg dhe keqpërdorshin nga të ashtuquajturit gjahtarë të “mishit”. Gjahtarët e mishit, si për tallje,



këtyre personave i venin pseudonime dhe thuhet se zgjidhnin emra femrash apo lulesh, si Mimoza a Vjollca.

Emërtimet e këtyre kuptoheshin nga të burgosurit, por edhe mes gardianëve kishte fjalë me kuptim të ndryshuar, siç i quan Lubonja fjalë me “autorësi gardiane”. Kështu, fjala “fole”, do të thoshte birucë ndëshkimore. Brenda kësaj gjuhe shihej ironia e përdorur. Kështu, të burgosurit dhe të tjerët, mirë e kuptonin kur nga shtabi, dërgohej nga diktatori udhëzimi “Të dekorohet”, që do të thoshte të eliminohej personi i caktuar. Lubonja, mësoi edhe fjalë të tjera, njëra nga këto ishte edhe “pajtos”, që e kishte dëgjuar në burg, por jo edhe në gjuhën e jetës së lirë.

Lubonjës, i duhej të mësojë kuptimin e ri të fjalëve, duke kërkuar shpjegimin e

përdorimeve të reja dhe e dinte që duhej të kërkojë një të burgosur, i cili për shumë vite kishte qëndruar në burg. Këtu gjen një të burgosur me emrin Zef Mala, mendimin e të cilit e respektonte ngase ishte një i dënuar për një kohë të gjatë nga sisteme të ndryshme edhe ai vetë thotë: “...e kam jetuar burgun në tri kohë”, kështu që mirë e kuptonte “gjuhën e burgut”. Biseda mes tyre nxiti shumë pyetje. Për Zefin këtu bëhej fjalë për gjuhë, ndërkaq Lubonjën e interesonte: Pse thua gjuha dhe jo zhargoni? Përgjigja ishte: “Sepse zhargoni është gjuha e krijuar nga të burgosurit, kurse fjalët që i përdorin edhe gardianët janë pjesë e shqipes që përshkruan burgun. Janë huazime që kemi nga gjuhët e atyre që na kanë sjellë burgun, siç kemi motor, karroceri, kofano nga


italianët që na sollën makinën. Gjatë vuajtjes së dënimit të parë, mbaj mend se për burgim fjalët mbizotëruese kanë qenë nga gjuha osmane. Burgut i thoshin me shumë hapsanë, sesa burg...” (histor.). Emërtimet ndërlidhen me kohën dhe sistemet, që Zefi kishte kaluar dhe vazhdon: “Pastaj hynë fjalët sllave të kohës së burgut tim të dytë” dhe jep kuptimin dhe etimologjinë e fjalës pendrek, për të cilën thotë se ashtu i thonë gomës së shkopit të gomës. Rreth fjalës pajtos, Zefi i përgjigjet që shkruhet pajdos, jo pajtos, që ndoshta e kanë marrë nga grekët. Në fëmijërinë e tij, mbante mend përdorimin e kësaj fjale për orën e pushimit të shkollës, apo për pushimin e drekës, për ata që punonin pasdreme. Por është përdorur edhe në kuptim të armëpushimit. Tani ka mbetur vetëm për orën e daljes për ajrim të burgosurve. Fjalën kaush e jep nga osmanishtja; kavushmak, që do të thotë të mbledhësh, “Dhe këtu neve na kanë mbledhur”. Zefi shpjegon historinë e këtij termi. Ai thotë: “Po. Por më kujtohet se një i burgosur i vjetër, në burgun tim të parë, që kishte bërë burg në kohën e Perandorisë tregonte se kaush i thoshin një qelie ndëshkimore ku futeshin për ndëshkim të burgosurit më të rrezikshëm që ishte si një pus në formë koni. Për shkak të bazamentit shumë të ngushtë, këta nuk mund as të shtriheshin dot, as të ecnin prandaj ishin të detyruar të rrinin në këmbë”.

Libri i Lubonjës vjen si trajtimi i gjuhës dhe i leksemave të burgut dhe kuptimit dhe përdorimit të koduar, edhe pse ky nuk ka qenë synimi i tij kryesor, duke shkruar mbi përjetimet e tij edhe të tjerëve në burgjet në Shqipëri gjatë periudhës së komunizmit. Por, te ky ligjërimit gjuhësor, nuk ka qasje gjithsecili, kuptohet vlen për një grup dhe mjedis të caktuar, por një vështrim i këtyllë vë në pah rëndësinë e gjuhës që ajo ka dhe kodeve e kuptimeve që bartin ato.

Lubonja, ka arritur ta shpjegojë rëndësinë e gjuhës që brenda burgut ishte mënyrë mbijetese dhe se si thotë ai vetë: “Fjalët e zhargonit të burgut mësoheshin e përdorshin ashtu, vetvetiu, dhe, me kalimin e kohës, bëheshin gjuha jote e parë”.

"SHKUPI", NJË HISTORI E NDRITSHME

Ardian Limani - Anton Pançev, "Bullgarët dhe serbët në artikujt e gazetës 'Shkupi' (1911-1912)", botoi nga Instituti për Politika Publike "Arbën Xhaferi", Shkup, 2023



Besnik EMINI

Doli nga shtypi libri "Bullgarët dhe serbët në artikujt e gazetës 'Shkupi' (1911-1912)" i autorëve Ardian Limani dhe Anton Pançev, i botuar nga Instituti për Politika Publike "Arbën Xhaferi". Libri është botuar në tre gjuhë (shqip, maqedonisht dhe anglisht) dhe bënë anëlizë të shkrimeve të botuara në gazetën "Shkupi" botuar gjatë viteve 1911-1912 në Shkup.

Botimi i artikujve të gazetës shqiptare "Shkupi" përgjatë viteve 1911-1912 e që flasin për bullgarët dhe serbët, përbën kontribut të rëndësishëm për të kuptuar më mirë ecurinë e zhvillimeve politike në Vilajetin e Kosovës, në shtetet fqinje, si Bullgaria, Serbia, por edhe në Perandorinë Osmane, e cila ishte në ditët e saj të fundit. Në kontekstin historik autorët i kanë dhënë edhe rrethanat politike ku u zhvillua dhe u rrit shtypi shqiptar pas vitit 1908 në territorin e Maqedonisë së Veriut. Së këndejmi, përmenden gazeta me peshë si "Bashkimi i Kombit", "Kalendari Afërdita", "Drita" të gjitha këto që botoheshin në Manastir.

Opusin publicistik më të rëndësishëm në këtë kohë e dha padyshim publicisti Jashar Erebara, i cili ishte një erudit dhe patriot shqiptar. Ky, sipas autorëve, nisi botimin e gazetës "Shkupi" më 1911. Për të kuptuar më mirë rolin e Jashar Erebarës, autorët janë kujdesur që të japin të dhëna

dallim në lidhje me karakteristikat etnike dhe për identitetin e popullsisë. Shtypi shqiptar në Maqedoni gjatë sundimit osman ka publikuar shumë materiale të lidhura edhe me politikën e Mbretërisë Bullgare, si edhe me jetën e përgjithshme të bullgarëve. Ndërmjet gazetave shqiptare më me famë në Maqedoni, edhe pse me një jetë relativisht të shkurtër, ka qenë gazeta "Shkupi". Në këtë gazetë ishin publikuar shumë vështrime për bullgarët dhe serbët në Maqedoni, por edhe për politikën e Bullgarisë dhe të Serbisë kundrejt Perandorisë Osmane dhe ndaj shqiptarëve.

Redaktor i kësaj gazete, rilindësi shqiptar, Jashar Erebara, ka pasur përgatitje shumë të mirë intelektuale dhe ka qenë njohës tepër i madh i politikës së asaj kohe. Për këto arsye dhe që të kuptojmë më mirë artikujt e gazetës "Shkupi", duhet të jemi në dijeni për situatën e përgjithshme gjeopolitike në kohën e botimit të gazetës. Duhet të kihet parasysh se gazeta "Shkupi" ishte botuar në një kohë vendimtare për Ballkanin, për kauzën kombëtare shqiptare. Në dekadën e parë të shek. XX ka pasur ide të ndryshme për zhvillimin e bashkëpunimit shqiptaro-bullgar në fushën politike dhe për luftë të përbashkët kundër Perandorisë Osmane. Mundësitë e veprimit të përbashkët shqiptaro-bullgar për çlirimin e Maqedonisë dhe të Shqipërisë ishte shqyrtuar nga faktorët vendimmarrës në Sofje pas Revolucionit Xhonturk, por pa rezultate strategjike për arsye të ndryshme.

Këto kanë qenë rrethanat gjeopolitike dhe rajonale në vigjilje të Luftës së Parë Ballkanike dhe që kanë ndikuar mbi artikujt e publikuar në gazetën "Shkupi". Atdhetarët shqiptarë, si Jashar Erebara, ishin të vetëdijshëm për këto probleme dhe nyja të pazgjdhshme ndërmjet shteteve ballkanike dhe midis nacionalizmave të popujve të rajonit. Jashar Erebara i kishte kuptuar shumë mirë këto "lojëra gjeopolitike" dhe i kishte kritikuar me të drejtë për dëmin që do të sillnin për interesat e shqiptarëve.

Lexuesit i bënë përshtypje se në shkrimet e tij Jashar Erebara kishte treguar aftësi të jashtëzakonshme analitike dhe kishte bërë parashikime të sakta për marrëdhëniet ndërmjet shteteve ballkanike. Këto parashikime burojnë edhe nga fakti se autori ka qenë shumë mirë i informuar për ngjarjet politike në Ballkan, si edhe për politikën e Fuqive të Mëdha ndaj gadishullit. Lajmet e publikuara në gazetën "Shkupi", shpesh kanë qenë të shoqëruara me komente të shkurtra, por të sakta. Edhe nga këto komente shihen edhe sot aftësitë analitike të autorit të tyre. Lajmet, komentet dhe analizat mbi çështjet politike të përditshme kanë qenë me theks mbi pasojat strategjike që do të sillnin. Pikërisht në këto analiza mund të shihet largpamësia e autorit të tyre, i

cili i kishte veçuar elementet dhe pasojat strategjike në gjoja ndodhi të përditshme. Bën përshtypje fakti se redaktori i gazetës "Shkupi" kishte përdorur shumë informata nga gazeta të tjera - osmane, bullgare, serbe, evropiane. Kjo qasje e kishte zgjeruar jo vetëm këndvështrimin e gazetës, por edhe tregon sa i informuar ka qenë redaktori dhe sa thellë ishte zhytur në politikën rajonale dhe evropiane.

Artikujt në "Shkupi" paralajmërojnë për rrezikun nga propaganda serbe, që kishte për qëllim shpërndarjen e urrejtjes ndaj popujve fqinjë dhe që kishte "argumentuar në mënyrë shkencore" pretendimet e Serbisë për dominim dhe për spastrim etnik ndaj "tjerëve". Jashar Erebara kuptonte shumë mirë se "propaganda e armatosur serbe" në Maqedoni ka pasur karakter të jashtëm dhe ishte mbështetur nga elemente të ardhura nga Serbia ose nga mercenarë, të rekrutuar nga popullata vendëse. Kjo politikë e Serbisë do t'i sillte masakra të shumta dhe shtypje të vazhdueshme populatës së Maqedonisë, pa dallime etnike.

Artikujt e gazetës "Shkupi" tregojnë edhe ekzistimin e një këndvështrimi realist mbi politikën e Fuqive të Mëdha. Jashar Erebara e kuptonte shumë mirë realitetin e hidhur të politikës evropiane, ku të drejtat etnike të popujve më të vegjël po flijoheshin pa asnjë fije turpi nga diplomacitë e shteteve të fuqishme për hir të interesave të tyre. "Shkupi" i kishte ndjekur dhe i kishte analizuar me kujdes interesat e këtyre shteteve, si edhe përplasjet ndërmjet tyre në Ballkan. Gazeta "Shkupi" ka qenë ndër gazetat më të mira shqiptare, edhe pse me jetë të shkurtër. Kjo gazetë i kishte vazhduar traditat e shkëlqyeshme të shtypit shqiptar që në kapërcyellin e shekullit XIX dhe në dekadat e para të shek. XX kishte dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për kauzën kombëtare shqiptare në të gjitha aspektet e saj. Artikujt e gazetës "Shkupi" nuk e kanë humbur rëndësinë e tyre, madje edhe më shumë se 110 vjet pas mbylljes së këtij organi të shtypit shqiptar. Hulumtuesit shqiptar, por edhe të gjithë lexuesit që kanë interes për zhvillimet historike në Ballkan, do të gjejnë në këto publikime lajme, komente dhe analiza objektive që do ta ndihmojnë kuptimin e ngjarjeve në vigjilje të Luftërave Ballkanike.

Gazeta "Shkupi", si edhe jeta dhe veprimtaria e redaktorit të saj, Jashar Erebara, meritojnë edhe hulumtime të tjera me qëllim që të ndriçohen në thellësi kontributet e atdhetarit të madh për kauzën kombëtare shqiptare. Për këto arsye, studimin për gazetën "Shkupi" dhe për veprimtarinë e Jashar Erebarës, meriton hulumtim të thellë. Hulumtime të tilla sjellin para publikut të gjerë jo vetëm faqe të rëndësishme nga historia e Ballkanit, por hedhin dritë edhe mbi rrugët e bashkëpunimit ndërmjet popujve tanë.

XHEVDET BAJRAJ, TINGULLI I PURPURT I MYSHKUT POETIK

Xhevat LATIFI


1.
Poeti njësohet me dhimbjen dhe bëhet një me plagët e atdheut, më pastaj është e zorshme të kuptosh, se edhe kur i shkruan dashurisë nëse është myshku që hardhia shpirtërore po i pikë dhimbje. Angelus Novus, engjëlli i ri, tufë poetike e Xhevdet Bajrajt, ka këtë aurorë, një tingull i purpurt siç ai e deshë lëngun poetik me ngjyra rrushi, ngre këtë relief të pulseve të zemrës, dhimbjen e dashurisë për atë copë dhe të etnisë që e mori kudo që shkoi pas, dhe na la në dorë si tapi, dhe kjo shihet sa herë që ulim sytë mbi këtë libër, e sa herë që shtrijmë shikimin në hardhinë e rrushit apo në mbrëmjet kur qielli merr pamje të purpurt të shikimit me paqe!

2. Sytë,
VETERANI/ I mungonin dy kilogramë / kur u kthye në shtëpi /Paj/ ishte kaq e dukshme / e kishte humbur një dorë / dhe të dy sytë / në luftë/

Ky personazh i poezisë së Bajrajt, ka humbur sytë dhe dorën në luftë, ai i kthehet nënës, dhe pret ajo t'i hapë portën, nuk është si kthimi në Itakë, ai pret t'i hapet porta, trokimën në derë nuk mund ta bëjë me dorën që nuk e ka, por ka dhimbjen fantomike, e kjo dhimbje vjen nga pjesa e trupit që nuk është. Ky gjenialitet i Xhevdet Bajrajt, prek atë që nuk e tha kush ndonjëherë. E paramendoni?! Një luftëtar po



kthehej dhe po shkonte me pa nanën! Zaten kështu bëjnë luftëtarët, kthehen triumfues dhe presin me i pa të dashurat, me pa pragun e shtëpisë. Po si do të shohë nënën heroji i Xhevdet Bajrës, kur ka humb sytë? Një epikë e veçantë sikur na thotë, ka dhe sy të tjerë, me të cilët ne mund të shohim ata që i duam, e kjo është me pa nga shpirti, me



pa nga brenda, tek e fundit e kështu kishte thënë dhe Visar Zhiti, sepse poetët shpesh herë kanë mallin përvëlues edhe për gjëra që kurrë nuk i kanë parë.
(Kur trokiti në derën e shtëpisë/në mesditë/ me zë të ëmbël tha /nënë/ më fal të lutem/hape derën/është natë e vonë/ pa hënë

3.
Xhevdet Bajraj, mësohuni me lirinë, është ëndërr e prituri 2 mijë vjet!

Tashti, në këtë kohë, diskursit kulturor njeriu modern i është futur, mbase i hutuar në atë që Umberto Eko, do ta quante "material i zi social, ku duhet shfletuar shumë për ndonjë margaritar. Nuk di nëse poetët kanë nevojë për ne, apo vetë ashtu të braktisur dhe të vetëbraktisur rrahin atë rrugën e bërjes së dhimbjes në art, Xhevdet Bajraj, në myshkun e vetë krijues, nuk është se vendosi bërryla për të kapërcyer shkallët e panteonit, për më shumë ai duket se tërë kohën mbante duart për të mos parë ata që qëndronin lart! Në Meksikë, ai po bënte punën që nuk mund të bëjnë diplomatët frigjid, kulturës latine po i bënte vend si emër i përveçëm, por dhimbjes për këtu nuk ju nda!

Po prekim rrënjët e hardhisë poetike të Bajrës, ka një porosi, aman mos ja vrisni andrrën këtij vendi se, për të ka ëndërruar dy mijë vjet! E jona është nëse duam t'i bëjmë fllad mendësisë sonë me poetët që shkuan të përmbushur andej me kokë mbetur prapa! Prapa mbetemi hiq pa njeriun si poeti Xhevdet Bajra, diçka që duhet të na therë thellë nishkun, pse kaq pak e duam njeri tjetrin? E kaq pak po mbesim çdo ditë, shumë pak!

Nuk është e vështirë/të bëhesh njeri/vetëm një hap përpara/gjithmonë/një hap para/duhet ta bësh/brenda vetes

Shënime

PELEGRINAZHI

Libri "Santiago de Compostela" me autor shkrimtarin Dashnor Kokonozi është një kënaqësi e vërtetë estetike nga faqja e parë tek ajo e fundit. Ai ia del mbanë plotësisht të të mbajë kureshtjen zgjuar, pavarësisht se ngjarjet përsëriten dhe kthehen në rutinë



Lindita KOMANI

Kjo është ajo kohë e vitit, kur pelegrinë nga mbarë bota ose e kanë nisur udhëtimin ose janë duke planifikuar udhëtimin për në Santiago de Compostela. Një shkëmbim i shkurtër me shkrimtarin Dashnor Kokonozi, autor i librit "Santiago de Compostela" m'i solli ndërmend shënimet e mëposhtme që kisha mbajtur për vete pas

leximit të tij në korrik 2021. Një vit më vonë edhe unë u gjenda në rrugëtim për në Santiago, jo nga e njëjta trajektore si ajo e autorit Kokonozi dhe jo duke kaluar nëpër të njëjtin mundim kohor sikurse ai, por aq sa për t'u frymëzuar e për të dashur që në një të ardhme ta mendoj të ndërmarr përsëri një shtegtim frymëzues sikurse ai.

U bënë vite që në listën e dëshirave kam përfshirë rrugëtimin për në Santiago de Compostela, ndaj kur në librari e pashë të ekspozuar tek librat e rekomanduar e mora menjëherë nga rafti, e bleva dhe nisa ta lexoj që pa mbërritur në shtëpi.

Libri "Santiago de Compostela" me autor shkrimtarin Dashnor Kokonozi është një kënaqësi e vërtetë estetike nga faqja e parë tek ajo e fundit. Ai ia del mbanë plotësisht të të mbajë kureshtjen zgjuar, pavarësisht se ngjarjet përsëriten dhe kthehen në rutinë. Edhe personazhet vetë, të cilët e nisnin jetën e tyre me këtë libër si episodikë e rastësorë në rrugëtimin e pelegrinut autor, rishfaqen kohë pas kohe, aq sa të përjetosh edhe një lloj zhvillimi për një pjesë të mirë të tyre. Takon aq shumë tipa të ndryshëm dhe kombësi sa që lumturohesh që bota është kaq e larmishme dhe që autori ka qenë i aftë të sjellë shumë prej saj në një libër të vetëm.

Rrugëtimi nis lart në Francë dhe përfundon larg në Santiago de Compostela. Qindra kilometra janë një hapësirë e mjaftueshme për të ndeshur në shumë histori dhe për të përjetuar edhe hapësirën gjeografike nëpër të cilën kalon ky rrugëtim, dallimin në mikpritje, prirjen me komerciale të bujtësve

francezë dhe natyrën më të ngrohtë dhe të përshtirshme të atyre spanjollë e baskë.

Kureshtja e autorit, e plotësuar me erudicionin dhe hulumtimet e tij, vëzhgimi me pozitivitet dhe përshkrimi i detajuar e me nota të këndshme humorit, të bëjnë të ndihesh sikur po ecën përkrah tij. Ndonjëherë doja t'i flisja që ta lëshonte përdhe çantën e shpinës ose t'ia zbrazja një pjesë të barrës që që të mos vuante aq shumë sa përftohej në lexim.

Humanizmi, adhurimi për të bukurën dhe historinë, sensi i aventurës dhe dëshira e vullneti për t'u bërë pelegrin ishin ato që duket se e shtynë të ndërmerre këtë rrugëtim prej 1800 km. Autori personazh gjen mundësinë të shkëputet nga puna dhe niset pa bujë, në një përpjekje trupore, shpirtërore dhe mendore, larg familjes, duke u mbyllur në heshtjen e tij që thyhet nga biseda të kohëpaskohshme me pelegrinë të tjerë.

Me interes është filli lidhës që autori krijon duke dashur të pasqyrojë apo më mirë të kuptojë vetë dhe më pas të pasqyrojë historinë shqiptare të pelegrinazhit për në Santiago. Që në krye, aty ku ai e nis rrugëtimin, në Vézelay, ai mëson që është shqiptari i parë në atë regjistër. Por kjo nuk e pengon pelegrinin autor që të vendosë si referencë Pjetër Budin, i cili e ka bërë këtë udhëtim disa shekuj më parë. Sipas autorit, emri Shijak që e mban një qytezë shqiptare, vjen pikërisht nga Shën Jaku, një dëshmi që kulti i Shën Jakut do të ketë qenë mjaft i njohur edhe në trojet e

shqiptarëve. Ishte pikërisht Shën Jaku i cili duhet se ishte "ndërmjetësi" në atë udhëtim. Zbulimi i fakteve rreth Shën Jakut duket po ashtu se është një qëllim i pashprehur si i rrugëtimit ashtu edhe i vetë librit. Shën Jaku e pret edhe në finish, në katedralen që mban emrin e tij. Në mbërritje, ai me të drejtë përjeton plotësimin e një misioni. Për katedralen autori shkruan:


"... u shpalo përpara meje me bukurinë e një filigrane të praruar që më të detyroi të mbaj frymën. Asnjë përfytyrim që kisha patur për të nuk i afrohej. Është madhesh-tore si jeta. Para saj ndjeva se nuk ka ëndërr të tepruar."

Leximi i librit u shtri në më shumë ditë nga sa e kisha parashikuar fillimisht, por ndoshta jo rastësisht faqet e fundit të tij i lexova në datën 25 korrik që me këtë rast mësova që ishte dita në të cilën festohet festa e Shën Jakut. Këto faqe dhe mësimi i këtij fakti me rastin e mbylljes së leximit më kulmuan përjetimin me një përlojtje të vërtetë si ato që ndodhin në çaste të rëndësishme të jetës. Për mua ishte një thirrje që ta ndërmarr edhe vetë këtë rrugëtim. Ai të mos mbetet vetëm një dëshirë, por të kthehet në një qëllim konkret. Për disiplinën në udhëtim lexova e mësova në të. Kam shumë punë përgatitore përpara, por kam njëkohësisht bindjen dhe gëzimin që po i përgjigjem thirrjes.

Dashur-padashur, rrugëtimi im për në Santiago de Compostela nisi më 25 korrik 2021.

SHQIPTARËT S'JANË LEXUES – SHQIPTARËT JANË SHKRIMTARË!

Në Shqipëri boton kush nuk priton, kush ka paratë e mjaftueshme: sponsorë kokëkulë apo prindër delirantë; botojnë nxënësit dhe studentët, prindërit dhe emigrantët; botojnë profesorët dhe veteranët, ish të burgosurit dhe politikanët, gratë e divorcuara dhe prostitutat e rehabilituara



Agron TUFA

Ja një gjysmë-aneidotë të cilën ma ka rrëfyer poetja Olga Sjedakova. Në një nga turnetë e shumta të leximit që organizonte propaganda sovjetë – midis shkrimtarëve dhe lexuesve të ndonjë ndërmarrjeje, uzine a regjioni, një grupi shkrimtarësh moskovitë u ra të udhëtonin në Jakuti dhe të ndërtonin një dialog të ngrohtë me masat e lexonjësve jakutë. Kështu, salla e Lidhjes së Shkrimtarëve të Jakutisë, në atë rast, qe plot. Prezantuan me bujë para lexonjësve Jevtushenkon, por lexuesi jakut nuk e njihnte. Provuam me Voznesenskijn, prapë jakutët s'e njihnin. Provuam me Samoillovin, jakutët as atë s'e njihnin. Atëherë shkrimtarët e shkretë filluan të pyesnin publikun:

- "Po Pasternakun, e njihni?"
- "Nuk rritet kjo erëz këtej nga anët tona", – u gjej një nga salla.
- Nuk është bimë, i thanë, nuk është erëz: është poet.
- Na ndejni, nuk e njohim, – thanë jakutët.
- Po Bllokun, Mandelshtamin, Ahmatovën... po Cvjetajevën... Tarkovskijn...? I keni lexuar?
- Atëherë u ngrit njëri:
- Kush janë këto zonja e zotërinj të nderuar? Ne nuk kemi dëgjuar asgjë për ta!"
- Po këta janë shkrimtarët më të dëgjuar të Ruisë, – briti i patakur Jevtushenko.
- Aha! – e kapi fillin njeriu nga salla, – harruam t'ju bëjmë një gjë me dije, qysh në fillim, zotërinj: Jakutët nuk janë lexues, jakutët janë shkrimtarë!"

Kjo situatë na ndihmon për të kundruar analogjinë dhe statusin e "shkrimtarit" shqiptar. Në kushtet e një boom-i entesh botuese, sot gjithsecili e ka mundësinë të botojë një libër, mjaft që të ketë tridhjetë deri në pesëdhjetë mijë lekë të reja në xhep. Tregtia që bëhet me botuesin i ngjan një situatë të rëndë e primitive të xhambazit apo të tregtarit të rëndomtë në pazar: jep lekët dhe, pas një jave, je bërë me libër! Botojnë libra gjimnazistët, çupkat ende pa mbërritur periudhën e pubertetit. Dhe veç t'i shohësh si kapardisen kapedanët dhe amazonkat familjare. Babai s'lë derë redaksie televizive apo gazete pa shkelur, pihet kafja dhe kryefamiljari fut pa teklif dorën në xhep të nxjerrë gesen me pyetjen standarde: "Sa do? Ape gojën! Jam i vendosur të mos e lë m'bë udhë talentin e sime bije. Veç dua të ma qëndisësh mirë artikullin, t'ma kullandrisësh kronikën hakçe. Ja dhe fotografitë...". Dhe bashkë me paratë, lë një turrë fotosh të çupkës melankolike me mjekër në pëllëmbë. Ai e di mirë si funksionon teknologjia e gazetave dhe e kamerave. Deri në promovimin e bujshëm ku poetët pleq, me sy të gapëruar nga rakia apo gojë të çapëlyer nga ndukja e ndonjë kofshe të pjekur, këpusin broçkulla e lëvdata për talenten e re. Tej në qoshk, e vetmuar, si një Serafim pikëllimplotë, ëndërron lavdinë e ardhshme poetesha e njomë, derisa një ditë, në pastë fat, do ta kuptojë tërë këtë maskaradë prindërore dhe do t'i zverdhjet dhe zelli – derisa një ditë (në pastë fat), në vend të parashikimeve hovardare të këtyre xhaxhove, do t'i mbetet një boshllëk i trishtueshëm në

parzëm dhe Safoja e re do të preferojë si gjithë vërsniket e saj të merret me ndonjë zbavitje më të fisme, ose në rastin më të mirë – të gjejë një të dashur, i cili t'ia zëvendësojë me sukses shkaku dhe melankolisë së vargjeve.

Në Shqipëri boton kush nuk priton, kush ka paratë e mjaftueshme: sponsorë kokëkulë apo prindër delirantë; botojnë nxënësit dhe studentët, prindërit dhe emigrantët; botojnë profesorët dhe veteranët, ish të burgosurit dhe politikanët, gratë e divorcuara dhe prostitutat e rehabilituara. Në Shqipëri botojnë librat e tyre ish-prokurorët dhe ish-ministrat, ish-diplomatët dhe ish-bodiguardët, kuzhinierët, këpucarët, dadot, rrob-aqepësit e diktatorit dhe familjes së tij; kunatat dhe rejat, ish-oficerët dhe oficerët në lirim, spiunët e sigurimit të shtetit dhe agjentët e kompanive të sigurimit, tregtarët e birrës dhe libra biznesmenësh që rrëfejnë se si ia kanë filluar zanatit, në fillim si qoftexhinjë që tash kanë mësuar formulën e suksesit. Por më shumë se të gjithë, në Shqipëri botojnë barinjët, katundarët dhe gazetarët. Bashkitë ose fondacionet për zhvillim në zonat rurale zëvendësojnë rolin e prindit për fëmijët e stadi para-adoleshent. Nuk ka mbetur familje, Derë e Madhe, trevë apo fshat që të mos ketë monografinë. Mandej vijne promovimet e bujshme në qytete, porositen ligjërata profesorësh, historianësh, akademikësh. Vijon ceremonia e trishtë e perverse me këndellje, rrahje gjoksi e kacagjelime. Auditorë të këtyre skenave bëhen muzetë e kryeqytetit, bibliotekat kombëtare apo universi-

tare, institutet apo fakultetet. Auditori i paralajmëruar mbushet me taboret e të ftuarve. Janë shembë krahinat për dere, pleq me qeleshe apo qylafë, pensionistë që u dridhet zëri i mallëngjyer, fshatarë që ngrihen nga fundi i sallës për të dalë në foltore, për t'i thënë dhe ata "nja dy fjalë". Ata përshkojnë sallën me një ecje të pasigurt, sikur çalojnë e piren shtrembër dhe mua më merr malli për ecjen e tyre natyrale, me drapër në dorë, kur drejtohen në arë për të korrur një krah hasëll për lopën. Rëndon del libri i një krahine, tempulli besimtarësh apo Dere të Madhe. Por merr valë, merr zjarr, merr sherr krahina fqinje: "Pse, vetëm ata na qenkëshin krye? Po ne? Pa dale, dale... se kemi dhe ne me ç'ta çudisim botën...". Gjenden paratë, porositet shkrimtari, që të kushtojë pak, zakonisht zgjidhet një format i bjerrur, gati ose krejtësisht i harruar i gazetarucit të shtypit të dikurshëm lokal. Bashkë me lekun, bashkë me fryrjen, atë e pushton deliri dhe merr hak për harresën e padrejtë: lëshohet si mizë blete, derë për derë, ku ka pleq në grahamat e fundit, përthyen fletorkën në gjuhë dhe kërren në letër gjithë broçkullat e një kujtese të çoroditur.


Libra shkruajnë ngado, libra shkruan çdokush, libra botohen tejpartej atdheut tonë, madje në një shqipe që do t'ua kishin zili edhe kurset e para kundër analfabetizmit. Por rekordin e zënë, padyshim, gazetarët. Çdo gazetar, potencialisht, është një shkrimtar. Edhe ata kanë librat e tyre. Varg e vistër. Madje vetëm ata duket sikur shkruajnë. Kush e ndal fushatën e tërbuar të librit të një gazetari? O, bravo solidaritetit! Librat e tyre reklamohen në faqet e gazetave, në vitrinat e librarive, në tele-ekrane, në promovime, në turne leximore Prishtinë-Vlorë. Kështu që, i dashur shkrimtar, rishtar qofsh ti apo i vjetër – struku, struku, mos u ndje, mos e hap gojën se të bënë gazin e botës! Thua je shkrimtar? E kujt ia thua këtë? Kush të paska lexuar? Ku bie, mor zotni, ky farë libri yt? Në librari? Nuk është! Je dallash, or lum miku! Të njohin për fytyrë? Ke dalë ndonjëherë në Klan, Top Channel, Vizion+? Jo? Atëherë ti s'qenke shkrimtar, qenke mashtrues, paranojak, delirant... Paske botuar zotrote nja dy libra! Shihe gazetarin X, deputetin Y, këshilltarin Z, të cilët, jo dy e tre, por të përgjigjen me një karikator të tërë me libra!

Po kush i lexon vallë? Ka dhe momente të tilla kthjellimi kur bëhet dhe kjo pyetje. Tash për tash, librat në botën shqiptare kanë zëvendësuar dhe janë një variant i suksesshëm i kartëvizitave. Në vend që të shkëmbejnë kartëvizita, shqiptarët shkëmbejnë librat e tyre. Të cilët askush s'i lexon. E pse t'i lexojnë?

Shqiptarët parapëlqejnë të shkruajnë.

Shqiptarët s'janë lexues.
Shqiptarët janë shkrimtarë!

Tregime: Anton PASHKU



KITARA

Zemra ime vallëzon vetëm atëherë kur dëgjon titrimin e telave të kitarës. Vetëm shpatat e zërit të saj mund ta copëtojnë brengën dhe t'ua falin flatrave të harresës. Po, vetëm kitara, kjo kitarë që rri përpara meje e varur aty në mur, mundet. Edhe pse tash frik jam mësuar të luaj me telat e saj, kitara ime lëshon zëra që, duke u ngatërruar ndërmjet vete, krijojnë jone, për mua shumë të

hareshme. Vetëm për mua! Them vetëm për mua, sepse tingujt e saj janë shumë të çuditshëm. Nuk mund t'i kuptojë, ose nuk do t'i kuptojë, gjithkush: qajnë kur duhet të gëzohen, gëzohen kur duhet të qajnë. Si tash më kujtohet vaji i vashës, që m'u lut t'ia këndoj një këngë. Pranova. Mora kitaren në duar. U ula pranë dritarës, duke shikuar në qiellin e natës, i cili, nëpër dritaren time, dukej

katërkëndësh me fillim, por pa fund. Pëlqeva telat dhe gishtat e mi zunë të luajnë nëpër to. Tingujt e kitarës përcillnin fjalët e këngës për Hënën e dashuruar në një yll që tradhtoi Diellin, i cili, zemëruar pamasë, shkriu që ta shëmtojë përgjithmonë fytyrën e Pabesës.
-Pse t'u mbush mendja ta këndosh këtë këngë?-pyeti ajo dhe sytë ia mbytën bulzat e lotëve që i gufonin pajada. Rudha krahët. Rudha edhe ballin. Nuk dita ç't'i them. Dita, por diçka më lidhi në fyt.
-Po pse, pse po loton?-dëgjova pyetjen mbasi doli prej gojës sime.
-Si...pse?!-tha ajo duke u munduar për t'i ndalë lotët, që i rridhnin nëpër faqe.
-Si, të lutem, si ka mundur Dielli të bëhet aq mizor...
-Mizor?!
-Po, po!-tha ajo-Si ka mundur të bëhet aq mizor ndaj Hënës, e cila për çdo mbrëmje del për ta stolitur lumin tonë me shtyllën e artë të rrezeve të veta?
-Shtylla e artë e Hënës?
-S'është e Hënës.
-Po e kujt është?
-Fol sa të duash, por ti s'je duke prekur telin e solit?
-Unë?
-Ti, pra. Të Pabesës...-thashë dhe u ndala. Mendimin, që desha t'ia them asaj, e përtypa në heshtje. Më shikonte. Pështja e shikimit të saj, që më kaploi, ishte tepër e rëndë. Ishte e rëndë sa s'bëhet.
-Mirë, mirë!-thashë.
Preka telat e kitarës sime. U krijuan tingujt që s'kishin lidhje me njëri tjetrin.
-A di çka,-tha ajo,-ta lëmë Hënën.
-Ta lëmë, nëse na lë.
-Mos u tall!
-Nuk po tallem.
-Atëherë, pra, jipja këngës për sumllën e djersës!
-Për sumllën e djersës, pa të cilën nuk mbin as therra për gardhiqë?
-Po, ke të drejtë.
-S'dua!
-Pse?

-S'dua t'ia them asaj kënge, sepse është e dhimbshme.
-Ani që është e dhimbshme, ani.
-Por ti s'e merr vesh!
-Si nuk e marr vesh!-tha ajo.-Vëllaut tim të vogël ia shoh sumllën e djersës sa herë që mundohet ta gënjejë nënën...
-Eh...-thashë unë.
Një e qeshur, për mua fare e pakuptimtë, shpërtheu në gojën e saj. Ishte aq therrëse dhe e padurueshme, sa mua më hypi gjaku në krye.
Shikova nëpër dritare: m'u duk se një yll kishte zbritur dhe tashti ishte mu përpara syve të mi. Çova dorën dhe mora hov: desha ta thej kitarën në një rën këmbë të atij ylli. Por, sjellja shkoi kot: ylli ishte larg, atje lart duke hequr valle me shokët e vet.
-Ha, ha,ha!-dëgjohej e qeshura e saj.
Mora kitaren. Drodha një tel. I thashë:
-Për ty, për lëkurën tënde pa asnjë pore!
Ndali të qeshurit. Më shikoi me ballë të mrrulur. Drodha të gjashtë tela e i thashë:
-Për ty, për ty që m'je tingull i pazëshëm!
-Paska tingujt të pazëshëm?
-Ja, paska!
Brofi në këmbë. Bëri një hap dhe u ndal përpara meje.
-Shiko veten, o i mjerë!-tha ajo.
-O gjuetar i ëndrrave, a s'po sheh se je krejt lakuriq!
-Unë?
-Ti, ti...A s'po sheh se ke mbetur lakuriq?...A s'po sheh se kitara të solli në këtë ditë të zezë?...Hidhe atë kitarë e mos rri kështu lakuriq, se do të bëhesh gazi i botës...
Zonjusha Vulë lëvizi vendit. Megjithatë, shtrëngova kitarën. Kitara u dalldis. Kurse ajo u mrrul edhe më shumë. Dikur fluturoi jashtë, duke mbyllur derën me forcë.
Mbeta vetëm unë, kitara dhe tingujt e saj magjike që përpiqeshin për ta zhदारitur rrapëllimën e derës së mbyllur...

(Shkurt, 1957)

NËN QARR PO Rrinte VASHA

Syni s'e sheh synin matanë hundës, zemra e sheh zemrën matanë bjeshkës (Thuhej dikur në Has)

1. Qetësinë, befas, e zhदारitari rrokullisja e një guri.
2. Mbasi guri theu qafën teposhtë malit, Dila e Marisë desh të çohet për të parë ku i kishte delet dhe a mos ishin trembur, por therra e murrizit, që iu ngul pardje kur shkoi ta kthejë një qengj që kish mbetur mbrapa grigjës, - e theri në thembër, e cila po i mblidhte qelb. E këputi dhembja e fortë: përsëri u shtri nën qarr. Ballin ia rimuan djersët. U zbeh. Mbylli sytë. Gjëja e fundit që pa Dila, para se t'i lëshonte këllkatëset, ishte qielli i gjerë ding me bashka të reve që, përtueshëm, udhëtonin dikah...
3. S'i ndahej dhembja. Therra e therte pajada. Iu duk se do të mbetej përgjithmonë aty, nën qarrin plak. Se nuk do të mund të çohet kurrë për t'i prekur kryet në krahoshën e varur në rremin e një

- dege të qarrit më të moçëm, më krahëhapur, më majëllartë se asnjë qarr tjetër në këto anë.
"O zot", mendoi, "a e di kush sa asht i vjetër ky qarr - dhetë, njëzet, njëqind apo, ndoshta, pesëqind vjet?"
4. Kur nxente dielli, qarrri lëshonte një hije të gjerë e të rrasët që ta flladiste shpirtin. Aty mund të shtrohej sofra për nja, mos i thashin rrenë, njëzet e katër burra, njëzet e katër cuba. Dhe ndoshta përnjëmend, mendoi kjo tashti. janë ulur ndonjëherë aq burra të dheut, aq cuba të malit - ku e di ti se jo! Por, megjithatë, s'kishte parë a dëgjuar kurrë se në hijen e qarrit të saj të dashur të kishin hëngër e pirë njëzet e katër burra, njëzet e katër cuba me mustaqe vesh më vesh - ku e di ti se po!
 5. Të gjithë e quanin Qarri i Dragonit. "Një të kemi!" i thoshin gjyshja e nëna. "Mo' atje, se t'shiton zana!"
 6. Gjyshja e nëna na i k'in pas kallëzuar se moti, aq moti sa askush i gjallë nuk e dinte kur, një Drangua kishte pas rënë në

dashuri me Zanën, shtatselvinë e katundit të tyre.
Mirëpo që në djep, në djepin me kaptell të shkruar me brisk për mrekulli.
Drangonin na e ki'n pa' fejuar me një tjetër. E tjetrën, të cilën kurrë s'e kishte parë, s'ia donte se s'ia donte zemra.
Po dhe Zanën që në djep në djepin që përkundte gjyshja gjithmonë në zi, na e ki'n pa' fejuar me një tjetër. E tjetrën, të cilin kurrë s'e kishte parë, s'ia donte se s'ia donte zemra.
Kur ki'n pa' marë vesh, vrer i zi na ish bërë babai i Zanës, mullan plot qelb e gjak të keq na ish bërë babai i Drangonit, kurse një ditë prej ditësh, Zana e Drangoni ki'n pas bërë fjalët për të ikur në mal - tinëz. Dhe ata ki'n ikur - tinëz. Dhe te qarrri na i ki'n pas parë pëllumbat e zogjtë krahëshkruar - të lumtur. Pëllumbat e zogjtë, mbasandej, kishin fshikur krahët në ajrin e pastër të qiellit të kthjellët si loti, dhe ki'n fluturuar gjithë ditën e lume përmbi katund për t'u kallëzuar njerëzve se Zana e dashka Drangonin - si ara e shkrumuar shiun. Por, askush s'i dëgjon-te.
Se katër burra, katër rrotela të kërlëshur, babai i Zanës, babai i të fejuarit të Zanës, babai i Drangonit, babai i së fejuares së

Drangonit haheshin. E kishin shkrehur: përsesh të bëheshin.
Dhe pëllumbat e zogjtë krahëshkruar u trembën nga krisma e martinave, plasja e kobureve, tymi i zi i barotit; tymi i zi i luftës fis me fis flaka për lau shtatë copë katunde.
E u kthyen pëllumbat e zogjtë, e i kallëzuan Zanës e Drangonit për çdo gjë që kishin parë. Zana e Drangoni ishin pikëlluar shumë, dhe ki'n thirrur pëllumbat e zogjtë e ki'n thënë:
"Amanet, o more pëllumba! Amanet, o more zogj! Kur t'na shihni se jemi shtri njani pranë tjetrit, ejani dhe ngjyeni nga një pupël në gjakun e varrëve tona dhe shkoni e i lëshoni katund m'katund, shtëpi m'shtëpi..."
Një qyqe e ngratë pat kukatur tri herë midis dy degëve të një lisi shumë të thatë.

7. Vashës që rrinte nën qarr, Dilës së Marisë, iu duk se ishte shtrirë mu në vendin, ku, Zana e Drangoni, kishin ndërruar jetë. Zemrën ia kaploi një nderim fort i thellë. Bile, luajti pakëz vendit, ashtu si luante edhe babai i saj kur përmendej emri i pajtorit të oxhakut të tyre.

8. Heshhte.

9. Tinëz, ngadalë, e zuri dëshprimi. Kurrnjëherë s'i ishte dukur vetja më e vetmuar, më e ngratë, se tashti. Çdo kush e kish harruar – iu duk. Iu bë se s'kishte njeri të lemë që mendonte për të. E, pra, aq shumë dëshironte që të mendonte dikush për të.

10. E mori gjogu i ëndrrave, i cili, si duhia, e çoi në trok drejt njëfarë vendi të panjohur, në një copë toke në midisdisit të detit. Eu, po kjo ishte njajo toka e çuditshme, për të cilën i kish kallëzuar Delia i Ndreut, i Ndre Delisë. Ç'mos i kish kallëzuar: atje, në atë farë toke të bukur, të cilën e kishte parë kur kish qenë në "ushtrinë e detit", dielli nxen gjithë ditën e lume kurse nata nata s'është natë, si këtu – hëna, sa një kallamboçe e çerepit, del nga deti dhe zdirë tokën midis ujit të njelmë, të cilit s'i dihet skaji. "A kurrë s'bie shi?" "Bie, por nuk asht si ky i yni, që t'ban gozhdar!" "Po thue?"

"Jo, për këta dy sy! Tekembrama, do ta shohësh..."
 "Kush ... unë?!"
 "Ti".
 "Unë?!"
 "Unë e ti".
 "Bashkë?!"
 "Pozi".
 "Po a je ti në mend? A s'e ditke hiq se m'kanë dhanë?!"
 "Si s'e ditkam, moj Dilë ..."
 "Ani edhe ty ta kanë zanë një tjetër!"
 Delia i Ndreut, i Ndre Delisë, e kish shikuar drejt në sy, të cilët Dila, prej turpit, i kish paluar. Delia, mbasandej, ia kish kapur krahu dhe ia kish shtrënguar aq fort, sa Dila s'pat duruar pa i thënë:
 "Uf, djalë, djalë ... ç'je tu' ba kështu?"
 "Mos u tremb, moj Dila e Marisë, mos u tremb!" kish thënë Delia i Ndreut, i Ndre Delisë. "Mos u tremb, ani që deti asht i gjanë e i fellë!, Do të dalim matanë dhe do të mbërrim në tokën në midisdisit të tij".
 Dila pa se Delia ish burrë që s'i vetëtonte ashkja e syrit.

11. Dëgjoi shushurimën e gjetheve, që zuri t'i fërkonte një erë e lehtë, e cila sillte pika shiu të ftohtë. Çeli sytë: qielli ish ndrysur

në të katër anët. U çua, mezi u çua: pa delet e tubuara në një rogë – krejt të frikësuar nga murmurimat dhe vetëtimat. I ndolli, dhe ato u nisen mbas Diles së Marisë që ecte duke shqepuar, që mbahej me të vështirë: therra në thembër e therte pajada. Kurse mali ushtonte. Njëpër ushtimën e tij të mnershme iu bë se dëgjoi një zë njeriu, i cili e thërriste. U ndal. Delet ikën para saj dhe, me krye teposhtë, tretën në shtegun e ngushtë dredha-dredha që shpjente në katund. Mbeti vetëm. Pa kur një si tojë e zjarrtë; tojë rufeje, u rrek për ta zdirur malin. U dëgjua një murmurimë e hatashme; si me dorë, diçka e preku në zemër dhe e lëshoi për dhë. Mbasi u rrëzua, mendoi se e vrau rufeja.
 "E pata!" tha dhe zuri të priste për të vdekur. Prite. Por, ama, nuk vdiste. Bile, si në kllapi, diktoi se dikush po e bante. Ngutshëm.
 "Aman, o zot, ty t'kofsha true, a m'kallëzon – kah je tu' m'çue?"
 "Kah deti. ... Në midisdisit të detit..."
 "Ani me therrë në thembër?"
 "S'asht gja therra... Therrën do ta qërojë deti..."
 "Aman, o zot..."
 "O, s'jam zoti, s'jam, moj Dila e Marisë, po jam Delia i Ndreut, i Ndre Delisë!"
 Një kalë i bardhë, ama më i bardhë se

korja e borës, që sall zjarr nuk vllte prej gojës, kaptoi Brinjën e Lisit të Gjatë dhe doli e treti në Bjeshkë të Lagamirit...

12. Bash kur kafexhiu po ia thoshte me zë . të ulët "po bjen shiu sixhim-sixhim, ç'po i qet vegshit ***** tym", në kafenenë e vogël të katundit – krejt i përllorur e me shpirt në fyt, - u rras Biba i Lleshit, Llesh Bibajt.
 "N'kambë, sokola!" bërtiti. "N'kambë, bre trima me fletë, se për qiell e për dhë na u nxi ftyra për jetë!... A s'pasket ndie?... Nji Drangue, nji thi karathi, na e muer Dilën nëpër shi... "Turr mbas meje!" tha Biba i Lleshit, i Llesh Bibajt dhe turravrap e theu qafën përjasht.
 Kurse Leka i Gjonit, i Gjon Gjolekajt, tha: "Çudë, çudë e madhe!"
 "Hë, çka polli?" pyeti Deda i Gjinit, i Gjini Gjidedajt.
 "S'e di hiq, bre burrë i dheut, pse njani sy nuk e sheh tjetrin?"
 "Dihet, he burrë!" ia kthei Deda i Gjinit, i Gjini Gjidedajt. "Fajin ma të madh e ka hunda!"
 "Hunda e ka fajin, pozi!" ia priti Leka i Gjonit, i Gjon Gjolekajt. "E di, por s'po di ç'duhet t'bjamë me këtë hundë?"
 (Qershor, 1959)

Bob Dylan

USTALLARËT E LUFTËS

Ju ustallarë të luftës, që i prodhoni të gjitha armët ndërtoni aeroplanët vdekjeprurës prodhoni bombat e mëdha, fshiheni aty pas mureve e sorollateni rreth tryezave; ta dini se mund t'ju shoh fare mirë përtej maskave tuaja!

Ju nuk keni bërë kurrë gjë tjetër veçse keni ndërtuar për të shkatërruar, ju merrni në duar botën time e lozni me të sikur me ndonjë marionetë, ju, ustallarë lufte, më ofroni sall armë dhe ikni nga vështrimi im, mandej kur plumbat fluturojnë rrotull ia mbathni e strukeni shpejt.

Si Juda Iskarioti gënjeni e sfrutoni llomotitni se bota fitohet me luftë rrekeni t'ma mbushni mendjen me çdo mjet, por unë fare mirë mund t'ju dalloj dhe t'ju zhbiriloj mendjet tuaja, njëlloj siç shoh ujën që rrjedh nga tubi im.

Ju jeni ata që këmbëzat i tërhiqni ndërsa të tjerët mes vete batërdisen, më pas bëni sehir për shtatë palë qejfe dhe kur vdekjet shtohen ndjeshëm, përdridheni në vilat tuaja tekta gjaku i të rinjve përskuq tokën e më pas shuhet i varrosur në baltë.

Ju keni përhapur frikën më të llahtarshme që mund të ndihet ndonjëherë, lindjen e fëmijëve në këtë botë mizore! Ju e kërcënoni foshnjën time ende të pa lindur, të pa ernër, sepse keni gjak të mallkuar që ju pluskon nëpër vena!

Jam ende i ri dhe flas pa kërkuar leje e ju mund të thoni se jam riosh i marrë që s'di se ç'flet - por unë e di mirë, megjithëse shumë më i ri se ju, se edhe Jezusi vetë s'do t'i falte të bëmat tuaja!

Pa më thoni, ju lutem, lumi i parave tuaja, a mund ta blejë faljen? Mendoni se mund të bleni çdo gjë? Vetëm kur vdekja do t'ju troket në portë do ta kuptoni se gjithë lekët e grumbulluara shpirtat s'do t'ju pastrojnë!

Dhe kur t'ju trokas vdekja vërtet arkivolin tuaj do ta përcjell në ndonjë pasdite me peizazh të zbehtë, do të shoh si ju shpënë në shtratin e vdekjes duke qëndruar aty sipër varrit gjersa të sigurohem se s'mbeti gjë nga ju.

1963

Charles Aznavour

LAMTUMIRË NËNË

Tashmë të gjithë janë këtu, dashuria e nënës i bëri bashkë, ajo po u lë shëndenë...

Më në fund ia behën të gjithë nga secili vend, nga më i vjetri te më i riu të gjithë tok rreth nënës.

Çilimnjtë lozin aty në fund të dhomës, "Shtttt, mos bëni zhurmë", vëmendja e fundit i kushtohet nënës...

Të gjithë kujdesen për të duke iu afruar me rend duart duke ia marrë dhe përqaftuar, tani kur ajo po ua lë shëndenë...

E Shenjta Mari, nëna e Zotit, O Zonjë që kupton dhimbjet, luten ata me zjarr duke kënduar: Ave Maria, Ave Maria! Sa shumë kujtime, sa shumë dashuri rreth nënës, sa shumë psherëtimë, sa shumë dhimbje therëse rreth nënës.

Takimi i fundit me nënën kështu mori formë, nëna po u lë shëndenë, një kavanoz me aromë peshku e nxorën dhe si rit tok pinë.

Çuditërisht s'ka trishtim, të gjithë janë dorëzuar, vëllai i madh lutet tjetri ia thotë një kënge për nënën.

Rreth motrës së madhe të gjitha gratë janë mbledhur, tani kur nëna po jep shpirt.

Aty pranë qiriu që digjet të gjithë përsërisin lutjen: Tungjatjeta Mari! Sa shumë kujtime, sa shumë dashuri rreth nënës, sa shumë psherëtimë dhe dhimbje therëse rreth nënës.

Ajo, kurrë, kurrë, kurrë... Nuk do të largohet nga ne...

(Shqipëroi: Bujar Mehollit)

Poezi: DURIM ÇAÇA

SARABANDA DHE VILANELE

MADRIGAL

muzgu që bie në terr
si gjoksi i një kali të zi në luftë

ah, s'ka asnjë kujtim
sado i ndritshëm të jetë
që të mos shuhet

t'dashurosh gjurmën e një trupi në rërë
më shumë se sa gruan
që ka qen' shtrirë në të

me gërshetat e zinj t'valëzuar
që shpërhapen si hardhitë
e reja në kopsht

e gishtat delikatë me nuancë
të kuqe zëmbakësh uji
në maj

nuk ka asnjë kujtim t'mos shuhet
sado që të jetë
i flaktë

buzëqeshja e vajzës që shkoi
si presa e ndritshme e një shpate
atje ku e shkuara shkon përgjithmonë

paj, tehu i mprehtë i gulshit të epshit
e kënga e gjinkallave që bie si një shi
i beftë nga qielli i verës

palca e eshtreve tona kthyer në vezullim
venat e gjakut n'fije zjarri të vrulltë

po s'ka asnjë kujtim
sado të jet' i dhembshëm
që të mos shuhet...

SARABANDË, 1

përbëhet prej shumë të tanishmeve
gjithëherë një "përgjithmonë"

përplasia e qerpikëve si krahët e kolibrit
kujtesa e fortë e gjakut
tonë
gruaja me flokë uji nën diell
e nxehtë si një shkurtë në afsh
hapja e dritares gjerësisht
për të pirë gjith' ditën e marsit
lulëzimi i bardhë i pemëve
si qumështi i gjirit të tokës
që rrjedh
kthesat fisnike që vizaton një çafkë
përgjatë qiellit në muzgun
e qetë

ah, se gjithmon' një "përgjithmonë"
përbëhet nga shumë të tanishme

"sërish e sërish shtrirë të dy poshtë
midis luleve ballë për ballë
me qiellin"
të jesh në ekstazë e iluzion
si një mënyr' për të theksuar stilin
nuse është emri që i thërras një vajze
një fluturë, një peme molle
një ylli
e dëshpërimi që detyrohet e mediton
se duhet të zgjedhë midis gjakut
e lotëve

përbëhet prej shumë të tanishmeve
gjithëherë një "përgjithmonë"

e blerta blu-marine e Bryzhit
kulti i formës si esenc' e thelbësore
parfumi i njom' mbi krahë, nëpër trup, i gruas
parfum prerie e bari të thatë ngjyr' jargavani
afër flokëve...

SARABANDË, 2

lër gjithçka të të ndodhë
bukuri, hov, tmerr *

lumturia më e madhe në botë
që është ajo e një iluzioni tjetër
Buda në lavdi, forma e ujit
hareja e virgjër e luleve
dehja e bletëve
dashuria e thell' që është të shohësh
te një njeri i përditshëm bukurin' e përjetshme
yllësimi, shkulumi, humnerimi, lulësimi
misteri me themele n' mungesën si prani
tramundana që merr gjethen e vryshkur
të mendjes

ah, ashk, shend, llahtari
gjithçka të të ndodhë, lër

sytë që duken ëmbëlsisht tragjikë
lajthia që këndon n' gjuhën tënde
aromën e vet
lavdia e buzëve, e trëndafilëve të kuq
si flakë që burojnë nga toka në vesk
retë ornamentale, këngët e dëshirimeve
gremina e dridhshme në natën e botës
puthja e ballit të gruas me delikatesën e zefirit
e solemnitetin e Solomonit
marrëzria e hershme e asketizmit
forca e jetës që gjendet te gjuha e shprehjes

lër gjithçka të të ndodhë
bukuri, hymn, tmerr

melankolia e qëndresës së vonë
dinjiteti i qetë i dhembjes
ngrohtësia shtypëse e zjarrit dhe afshit
në vatrën e kasolles së kreshtës
e njeriu që përgjunjet vetëm kur falet
a për të njohur vetveten...

VILANELË, 1

çdo gjë është e thjeshtë
si mësimi i puthjes

vezullimi i zjarrit të brendshëm
drita e zambakut të fushës
vallja shamanike n' ujvarë
struktura sintaksore e realitetit
tingëllimi i kudhrës së farkëtarit
dija jonë e përsosjes
ah, se një me lumin e qenies
lotët e ëmbël të rinisë
lotët e njelmët të të vjetërve

porsi mësimi i puthjes
seç është çdo gjë e lehtë

përplasia e valëve në shtuf
firoma e armësht e bisqeve
ajthi i mallit mes shkulumesh
kurmi i vajzës së vogël
me arom' luleshëngjergji
bota që përbëhet nga fjalë
bletët nëpër arin e kolzës
t' folurit me saktësin' e rreptë
që kërkojnë çastet e fundit

seç çdo gjë, paj, e thjeshtë
si mësimi i puthjes

jeta që na krijon ngaherë
t' rrojturit për mall e kujtime
violina e trupit të gruas
n' tinguj gishtërinjsh afshi
floriri vjeshtor i vidheve...

VILANELË, 2

kur çlirohem nga ai që jam
bëhem ai që mund t' jem

visi i largët mjegullor ndriçuar e rrënuar
nga dashuritë e dhembjet

burbujë krahësh gugurues pëllumbash
tek përplasen n' shend në një ftua
të gjelbër

përmallje e egër n' kërkim të diçkaje absolute
që bashkon fjalë, si: baba', Zot, det, dëlirje
vdekje, poemë, ajth, vuajtje

përshkënditje përlojtjeje e melankolisë
së re të mugët

ah, se bëhem ajo çka mund t' jem
kur çlirohem nga ajo ç' jam

dije e të shenjtëve që buron
prej përvojës së vet mëkatore

shtëpia e shkret' kur ikin përgjithmon' qeniet
që u dashuruan e u plaguan
brenda saj

energji e brendshme për tmerr si një përzierje
fuqie kozmike, urrejtjeje, afshi
trishtimi, hareje

kur çlirohem nga ai që jam
bëhem ai që mund t' jem

dalldia ephore e heroit
n' çastin më të rrezikshëm të betejës

mëgjepsje që jep humnera e errtë natën me hënë
ndërliksje dëlirësie e sensualiteti të fshehtëj

stuhit' e mëdha që ëndërrojnë detet kur flenë...

* Sarabandë, (nga spanjishtja: zarabandë, lloj valleje popullore spanjolle e shek. XVII), suitë në muzikë, kompozim që përbëhet prej kohësh kontrastuese, epike dhe lirike, ndërthurur me njëra-tjetrën. Në rastin tonë, të përdorimit të këtij termi, si emërtim i këtij cikli lirik, (ashtu si në cikle të tjerë: lid-e, samsara, vilanele, etj.), është thjesht si element formal estetik, pa patur lidhje me strukturën e këtij zhanri artistik.

* Vilanelë, (nga italishtja- villanella), këngë ose valle e kënduar popullore e traditës së hershme italiane folklorike rustike, (me përmbajtje fshatarake e pastorale), e ndërtuar me 19 vargje, 5 tercina dhe 1 katrenë, ku vargu i tretë përsëritet si refren në strofën e tretë dhe të pestë dhe po kështu përsëritja e alternuar e vargut të tretë përkatës, e strofës së dytë në strofën e katërt, dhe të vargjeve refrenë, si reprizë në katrenën përmbyllëse. Vilanele të bukura kanë shkruar dhe poetë të shekullit XX si, ata anglezë: D. Tomas, E. Auden; amerikanë: E. Arlington Robinson, E. Bishop, S. Plath, etj. Në rastin tonë, të emërtimit të këtij cikli tonë lirik, vilanelë nuk ka lidhje me strukturën përmbajtësore- ritmike të kësaj tradite folklorike, por është përdorur thjesht si element formal estetik.

QËLLIMI FISNIK I REMBRANDIT

Nuk është e arsyeshme që të rrosh dhe, të mos pëlqesh. Ashtu sikur, nuk është e arsyeshme, të kesh qëllim dhe të mos përpiqesh. Ashtu sikur, nuk është normale, të kesh ideal, e të mos kesh idhuj. Ndryshe, gjithçka shkon me ritmin e së zakonshmes.



Ilir LEVONJA

Sipas Gledis Shmid, biografes më në zë të Rembrandit, piktorit i madh holandez thoshte shpesh: "O, bëhem një Mikelanxhelo i ri, o një gomar". Kjo është tepër argëtuese vërtetë, sepse i ke shpallur luftë pa kompromis vetvetes. As që bëhet fjalë fare, për pak prehje. Rembrandi, e nisi kështu betejën dhe armët e tija ishin talenti dhe frymëzimi. Bota ne sytë e tij ishte krejt ndryshe nga sytë e të tjerëve. Ndoshta, nga ky vështrim i veçantë lindën dhe veprat e mëdha, nga ky vështrim i vëmendshëm, që ka mundësuar krijimin e një qëllimi te vetëm e fisnik, kthimin e së bukurës në një vepër të dobishme. Ky qëllim, e afron punën e krijuesit me atë të zotit.

Kur parapëlqejmë dhe përpiqemi të rritemi, duke i ngjarë atij që na frymëzon, kjo do të thotë se rritemi me qëllimin e lart, te vetmin, me etjen për të qenë të shenjtë për të bërë punë të bukura. Askush nuk do ta kuptoj atë që, për krijuesin, respekti me i madh, është ta lësh atë të lirë. "Marrëzitet" e tija, asnjëherë nuk kanë për ta çuar njerëzimin drejt fatalizmit.

Qëllimin e tij, Rembrandi e arriti duke mbushur vetveten me dashurinë për Mikelanxhelon. Ai preferonte dhe rritej, duke ëndërruar dikë, që ishte dikushi, dikë që ishte gjeni, dikë të ndëshkuar prej gjenisë së vetë. Kjo është më se e natyrshe dhe s'kemi përse të trembe mi. Gjithkush ka ndjekur gjurmët e pararendësve për të arritur majën.

Nuk mund të arrihet deri këtu, ku ndodhemi sot, pa kaluar nëpër duar veglat e epokave të mëparshme, punën e njerëzve paraardhës. Është pikërisht kjo etje, kjo përpjekje, që na bën të ndërgjegjshëm për misionin fisnik të krijimit. Kjo e nderon qëllimin tonë.

Gjithmonë e keqja jonë e madhe ka qenë interpretimi. Nga ky këndvështrim, shpesh here ndodh që, shqetësimet t'i

marrin për pretendime. Unë këmbëngul se të shqetësohesh nuk do të thotë aspak se pretendon. Të shqetësohesh është krejt e natyrshe, deri sa je në kërkim të kryeveprës, ose thjesht një vepre të dobishme. Duhet maturi dhe urtësi dhe në këtë sjellje të lartë duhet ta kërkojmë edhe te tjetri. Kur nuk e gjejmë, shqetësohemi, e pikërisht këtu lind kontradikta, sepse shqetësimin e treguar, të tjerët e interpretojnë për pretendim. I vetmi që na vjen në ndihmë, është ai që rron brenda nesh, këshilltari..., ose vetvetja, ai me të cilin bisedojmë shpesh.

Qëllimin tonë të mirë askush nuk e respekton, megjithëse në konferenca shtypi, shtetarët shpesh argumentojnë platformat me ndihmën e veprave tona. Kjo është tragjike, për vetë faktin se midis konceptit dhe realitetit ekziston një distancë të cilën e mbajnë pezull keqinterpretimet. Po kjo nuk do të thotë aspak se edhe nëse ekziston ai, këshilltari brenda teje, të mos ndodhi i njëjti keqkuptim. Ai vetëm se do të ta lehtësojë brengjen, është njësoj si të thuash, që ke se me cilin bisedon e aq më tepër, kur ti ke nevojë të zbrazesh. Makiaveli, për shembull, ishte një nga këshilltarët më të shkëlqyer që ka njohur historia, ose u bë i tillë pasi publikoi "Princin", sikur vepra t'i kish pararendur kohës, kombi italian nuk do të rronte i ndare. Besoj të ketë qenë kjo arsyeja që, Ali Pashë Tepelena, në muzgjet e ëmbëlta të Janinës, diku buzë liqenit, të dëgjonte shërbyesit e tij të t'i lexonin pjesë nga Makiaveli. Megjithëse, sipas të dhënave dhe aq sa e njohim Ali Pashain, të krijohet përshtypja se ai Makiaveli, shpesh i dukej sikur s'thoshte ndonjë gjë të re, por sidoqoftë e argëtonte.

Nga kapitulli i fundit i librit të tij, "Princi", ia vlen të shkëpusim disa radhë për të kuptuar mirë peshën e fjalës se këshilltarit, njeriut që rron brenda teje, atij që shpesh na bën të dukemi sikur po flasim me veten... Ja një paragraf: "Duke,

medituar mbi gjithçka të parashikuar më sipër, (e ka fjalën për atë që nuk zhbëhet më), duke analizuar se sot Italia, kur kohërat janë të tilla që t'i japin mundësi një princi të ri, të bëhet i shquar, mund të gjejë rastin dhe mjetin për t'i dhënë këtij vendi një formë të re, që këto shërbime ta mbulojnë me lavdi princin dhe banorët e vendit me pasuri. Me duket se rrethanat që shkojnë në favor të një plani të tillë janë të shumta, aq sa s'mund të them se nuk ka pasur kurrë një kohë të përshtatshme sa koha që jetojmë për ndryshime të mëdha. Në rast se për të njohur virtytet e Moisiut, popullit të Izraelit u desh të ishte skllav i egjiptianëve, nëse për të shpërthyer me krejt shkëlqimin e vet madhështia e shpirtit të Siriusit, u desh që përsët të shtypeshin prej medëve. Dhe së fundi, për të vlerësuar trimëritë e Tezeut duhej që athinasit të ishin të përçarë, po ashtu edhe në ditët tona, që dikush të shquhet, duhej që Italia të katandisej aty ku e shohim sot; më e shtypur se hebrejtë, më e skllavëruar se përsët, më e përçarë se athinasit, pa drejtues, pa institucione, e rrahur, e çjerrë, e pushtuar, e sakatosur prej të gjitha mynxyrave. Deri më sot, duket sikur disa vegime të herë-pas-hershme, kanë dashur të paralajmërojnë ardhjen e një njeriu të zgjedhur prej perëndisë për çlirimin e saj. Po, nuk do të vononte që ky njeri të ndahej prej fatit në mes të karrierës së tij të ndritur, ndaj ende sot, thujse duke dhënë shpirt, ajo është në pritje të atij që do t'i mbyllë plagët, të atij që do t'i japë fund plaçkitjeve dhe grabitjeve prej të cilave vuan sot Lombardia, t'i jap fund kusarive që po shkatërrojnë mbretërinë e Napolit dhe Toskanën, e së fundi, të shërojë ato plagë të thella që tashmë janë bërë fistuloze".

Nga teksti i mësipërm, nuk është e vështirë të kuptohet se qëllimi i Makiavelit, është t'i kujtojë njerëzimit, kryesisht politikanëve, mundësinë që ata të bëhen "prince" të reformave. Sajimi në

mënyrë të përkryer i një princi, duket sikur qetëson shpirtin e lodhur të Makiavelit, ndërsa na jep edhe neve shansin që në fronte të ndryshme, të paktën t'i afrohem këtij konvencioni.

Më kujtohet se pas rënies së diktaturës komuniste, kur unë jetoja në Lushnje në vitet 90-të, u shfaqën grupe te rinjsh me origjinë italiane, të cilët predikonin Baha' i -in. Ata shpesh thoshin se, "synojmë një botë pa kufij". Kjo ishte një thirrje që ngjalli interes tek ne dhe njerëzit në përgjithësi, sepse ne ishin te lodhur nga hermetizmi i telave me gjemba, nga retorika e parimeve të socializmit. Kjo, thirrje, na bëri të tregoheshin të vëmendshëm ndaj Baha'u'llahut, sidoqoftë mangësive mbi konceptimin e fesë, për shkak të ateizmit shtetar të ish diktaturës së proletariatit. Megjithatë, aty u pa qartë, etja e njerëzve për të qenë aytetarë të një bote të tillë, pa kufij.

Në këtë këndvështrim, kam pasur rastin që, pikërisht pas këtyre viteve, sidomos në kohë fushatash elektorale, miq të mi, apo të njohur..., të cilët hepar nga entuziazmi dhe ekstaza bënin premtime faraonike. Pavarësisht intimitetit, privilegj ky që ta jep miqësia, nën një kujdes të akullt unë pyesja vetveten: "A ekziston brenda këtij njeriu, qëllimi fisnik i Rembrandit, apo princi i ëndërruar i Makiavelit?".

Për të shuar kureshtjen, sërisht fal privilegjit që të jep shoqëria, pyetjen time e sendërtova, pra e bëra të gjallë, të vërtetë.

-A rron brenda teje, qëllimi fisnik i Rembrandit, apo princi i ëndërruar i Makiavelit, miku im dhe kryetari i ardhshëm?

-O çun, zgjoh, shikoje jetën në sy se librat të vënë në gjumë, - tha ai..., kryetari i ardhshëm.

Duke gjykuar se, edhe populli im e ka përtërirë shpresën e besimit, shumë shpejt ai (populli, jo kryetari) do të ndjehet i përfshirë në ethet e këtij..., qëllimi fisnik për të prodhuar vetëm progres. Përpara është një demokraci e re, që domethënë se, popullit i është dhënë mundësia. Në kësi raste, ai është njësoj si krijuesi. Duhet të mos pezmatohet nën kushtet e një përpjekje, për të arritur përsosmërinë dhe tokën e premtuar. Sepse, rënie të tilla karakterizohen nga katastrofa të pa shembullta, si luftë civile, përndjekje, vrasje, anarki. Nuk është e vështirë për të kuptuar, se gjithçka që më rrokin sytë, gjithçka të kësaj mbrëmje që jam duke shijuar, se mos ekzistojë me. Për shembull, ndërthurja e mendimeve dhe e hamendësimeve, puhiza nëpër gjethet e gështenjave ndan bulevardit, njerëzit që shkëlqehen e bisedojnë, dritat e semaforit, fishkëllima e një bilbili, boritë e një karvani makinash që shoqërojnë një çift të porsamartuarish etj. (Një shembull të tillë e bënë, viti 1997.) Ne gjithmonë duhet të bëjmë përpara, vetëm nëpërmjet vullneteve të lira, ne duhet të inspirojmë vullnetet të tilla për të kuptuar realitetin krijues, të drejtat e ndërsjella dhe funksionin e partneritetit, elemente jetike këto për një shoqëri demokratike. Pra, shoqërisë këtu i duhet të jetë kreative, t'i ngjasoj krijuesit, të marri një mision në përditshmërinë saj, aq sa, në të njëjtën kohë, ajo t'i japë mundësinë dhe individit të kapi përmasat e reformatorit, të prodhojë pikërisht atë princ që e ëndërronte Makiaveli. Kjo na bën të mendojmë se natyra biologjike e shoqërisë dhe krijuesit, janë si dy shpirta binjakë, të cilët duhet medemos të mbartin në vetvete një qëllim fisnik..., sigurisht, kryeveprën.

Profile: *Timothée de Fombelle*


"TOBI", "KAPITENIA ROZALI" dhe "CELESTE, PLANETI IM"

Në njohjen e mëtejshme të shkrimtarit *Timothée de Fombelle* dhe krijimtarisë së tij, Sh. B. Mediaprint, në vitin 2022, na ka sjellë në shqip një gur të çmuar me emrin "Kapitenia Rozali", përkthyer plot finesë dhe dashuri nga Adriana Koxha

Xhahid BUSHATI

U lind në vitin 1973, në Paris. Babain e kishte arkitekt. Shpesh e merrte me vete në Afrikë. Një pjesë të fëmijërisë e kaloi në Marok dhe në Bregun e Fildishtë. Çdo verë, familja e *Timothée*-s pushonte në një fshat që gjendej në Francën perëndimore. Në pyllin më të afërt të fshatit, ai së bashku me motrat e vëllezërit e tij luanin në pyll, interpretonin pjesë të ndryshme për prindërit e tyre, si dhe frekuentonin bibliotekën e fshatit. Në moshën 17-vjeçare themeloi grupin teator "La Troupe des Bords de Scène", për të cilin shkroi dhe vuri disa pjesë në skenë. Dashurinë për dramaturgjinë nuk e la kurrë. *Timothée*, në fillim ishte mësues letërsie, pastaj dha mësim në Paris e Vietnam. Është i martuar me *Laetitia*, e cila është aktore dhe boksiere amatore. Çifti ka një vajzë që quhet *Jeanne Elisha*. Ajo ka lindur në vitin 2004.

Timothée shquhet si dramaturg. Në dramën e tij "Unë gjithmonë kërcëj" trajton problemet dhe raportin mes humbjes dhe brishtësisë; me komedinë e titulluar "Macet e trëndafilut" fitoi emër. Dramat e tij janë përkthyer në disa gjuhë, si: gjermanisht, italisht dhe greqisht. Në vitin 2006, ai bëri debutimin e tij si autor me "Toby Alone", një roman për të rinj, botuar nga Sh. B. Gallimard Jeunesse. Romani pati sukses të madh, dhe njohu një përkthim në 30 gjuhë. Autori për veprat e tij është nderuar me 20 çmime, duke përfshirë çmimin "English Marsh", çmimin italian "Andersen", dhe shumicën e çmimeve franceze për letërsinë për fëmijë. "Toby Alone" dhe vazhdimi i tij "Tobi dhe sekretet e pemës" (roman, 2007) tregojnë historinë e një djali të gjatë një milimetër e gjysmë, i cili jeton në një pemë



lisi dhe duhet ta shpëtojë atë nga shkatërimi. "Për mua, pemët janë planete të gjelbra, dhe si këto pemë planeti im TOKÉ është, gjithashtu, i rrezikuar..." - thotë në një intervistë shkrimtari francez. Më pas, romanet për fëmijë kanë ndjekur njëri-tjetrin duke çuar lexuesit e të gjitha moshave në aventura të mëdha, duke i dhënë vend krenarisë, imagjinatës, emocionit dhe poezisë, duke shprehur gjithëfuqinë e fëmijërisë. *Timothée* e zgjeron krijimtarinë e tij letrare, duke e pasuruar me zhanre të ndryshme dhe i shumëfishon bashkëpunimet duke krijuar albume, përralla muzikore... etj., pasuria dhe hiri e së cilës veç e veç dhe e marrë së bashku e kanë vendosur atë si një nga shkrimtarët më të shquar të brezit të tij. Midis viteve 2016 dhe 2020, *Timothée* u

zgjodh 5-vjet radhazi për çmimin prestigjioz suedez "Astrit Lindgren" për të rinjtë.

Po përmendim disa vepra të tjera të autorit: - "Celeste, planeti im" (roman, 2009), - "Midis qiellit dhe tokës" (roman, 2010), - "Një princ pa mbretëri" (roman, 2011), ... etj. - Nga ky autor, Sh. B. Mediaprint për lexuesin shqiptar ka sjellë dy romanet e tij të suksesshme: "Tobi - një milimetër e gjysmë guxim" dhe "Tobi - sekretet e pemës". Nga leximi im mbresëlënës i këtyre dy veprave të shquara, po hedh këto shënime që i gjeta në bllokun tim e, që do t'i zgjeroj në të ardhmen drejt një optike më të gjerë. Shënimi është ky: "Një aventurë e ngarkuar me çmime heroizmi, miqësie dhe mbijetese - me një mesazh të fuqishëm ekologjik - vendosur në një botë

magjepsëse në miniaturë. Tobi, ndonëse është vetëm një milimetër e gjysmë i gjatë, është personazhi më i kërkuar në botën e tij, i cili është Liai i Madh. Kur babai i Tobit bën një zbulim novator, duke prekur thelbin e energjisë së Pemës, ai, gjithashtu, kupton se shfrytëzimi i saj mund të dëmtojë përgjithmonë botën e tyre. Duke refuzuar t'i zbulojë sekretin e shpikjes së tij në mjedisin e një komuniteti të tërbuar, familja e Tobit internohet. Nga ana tjetër është një njeri, i cili është i vendosur për të kapur njohuritë e ndaluara..., dhe plani i tij famëkeq e ogurzi është të shkatërrojë Pemën. Por, tani, prindërit e Tobit janë të burgosur dhe të dënuar me vdekje. Vetëm Tobi ka arritur të shpëtojë, po për sa kohë?."

Në njohjen e mëtejshme të shkrimtarit *Timothée de Fombelle* dhe krijimtarisë së tij, Sh. B. Mediaprint, në vitin 2022, na ka sjellë në shqip një gur të çmuar me emrin "Kapitenia Rozali", përkthyer plot finesë dhe dashuri nga Adriana Koxha. Ky libër është një ndër tre librat e përzgjedhur në vitin 2018 nga "Le Figaro" për t'u rrefyer fëmijëve kujtimin e Luftës së Parë botërore me delikatesë dhe filozofi. Në tekstin shoqëruar të librit thuhet këto fjalë: "Libri "Kapitenia Rozali" rrëfen historinë e një vaje të vogël të mbërthyer në trazirat e luftës. Ajo përfaqëson përvojat e mijëra fëmijëve, baballarëve e të cilëve kanë shkuar në front, ndërsa nënat detyrohen të punojnë, shpesh në fabrika, për të plotësuar nevojat e tyre. Megjithatë e vogël, Rozalia është plot imagjinatë, për shkak edhe të peshës së luftës dhe mungesës së babait. Nena e saj ia lexon letrat që ai dërgon, por Rozalia dalëngadalë dyshon në përmbajtjen e tyre të vërtetë. Ajo nis të kërkojë të vërtetën. Ky mision do t'i japë asaj një medalje!"

Histori

184 DITËT E SOFISË

Albanologia e njohur *Edit Durham* ka parasysh me këtë fjali princshën *Sophie von Schoenburg-Waldenburg*, të shoqen e princit prusian *Wilhelm zu Wied*, që në Gjermani ende njihet me emrin *Wilhelmi i Shqipërisë*. Më 7 mars të vitit 1914, pra 95 vjet më parë, *Sofia* erdhi në Shqipëri në krah të të shoqit, *Wilhelm zu Wied*. Kur më 7 mars të vitit 1914 çifti princëror *Zu Wied* do të zbarkonte në Durrës, duke shkelur për herë të parë tokën shqiptare, nuk e dinte që qëndrimi i familjes katëranëtarëshe në atë vend të turbullt do të zgjaste vetëm 184 ditë. Por ata e dinin që më parë, që "aventura shqiptare" nuk do të ishte e lehtë. Edhe vetë perandori *Wilhelm II*, që sundonte atë kohë në Gjermani, e kishte paralajmëruar princin prusian, të cilin e kishin kushëri të dytë, "që të mos turpërohej duke u ulur në fronin e saposhpikur të Shqipërisë". Por siç konstaton historiani nga *Glahau*, *Roby Joachim Goetze*, shtysën kryesore për këtë "aventurë" *Wied-i* e kishte marrë nga e shoqja: "*Wilhelm zu Wied* me siguri që do të mjaftohej me karrierën e zakonshme për aristokratët e asaj kohe, pra të bëhej gjeneral për shtetin. Por mbretëresha e

Rumanisë kishte plane ambicioze dhe e shtyu të shoqin, mbretin rumun, *Karol*, që *Wilhelm zu Wied* të konkurronte për fronin shqiptar. Në këtë vendim, rolin kryesor e pati *Sofia*, që ishte tepër euforike", thotë *Goetze*. *Goetze* është muzeolog dhe anëtar i kryesisë së shoqatës "Artis Causa E.V.", që e ka selinë në kështjellën *Valdenburg*, rezidencën prindërore të princshës *Sofia*. Pikërisht në këtë kështjellë, në vitin 1906, aristokratja, asokohe 21 vjeçe, u martua me princin *Wilhelm zu Wied*, me kumbare tezen e këtij të fundit, mbretëreshën *Elisabet* të Rumanisë, e cila njihet edhe si shkrimtare nën emrin *Carmen Silva*: "*Carmen Silva* pa të *Sofia* një njeri të jashtëzakonshëm dhe donte patjetër ta fuste në familje. Prandaj edhe rregulloi martesën me nipin e saj, *Wilhelm zu Wied*", thotë *Goetze*. Pas martesës, çifti i ri shkoi në Berlin, ku *Sophie von Schoenburg Waldenburg* manifeston talentin e saj si organizatore aktivitetesh kulturore: "Duke ndjekur shembullin e *Carmen Silva*-s, ajo krijoi në Berlin një rreth artistik, një sallon muzikor ku mbështeste artistë të rinj të talentuar, po ku merrnin pjesë edhe

muzikantë të njohur, si *Engelbert Huberding*, *Max Reger*, *Max Bruch* apo *Charles-Marie Widor*". Pikërisht kjo damë sallonesh u caktua të bëhej princshja e Shqipërisë në vitin 1914. Për të ky ishte një shans i madh në jetë. Por siç doli më vonë, llogaria e saj kishte qenë e gabuar. *Sofia* e njëjta Shqipërinë nga librat: "Më parë kishte qenë në Pogradec një delegacion, që i kishte mësuar asaj sesi të sillej në Shqipëri: mundësisht të mos kalëronte, të mos shfaqej shpesh në publik dhe të mos vishte fustane dekolte. Por ajo, si një grua moderne evropiane, për fat të keq nuk iu përmbajt këtyre rregullave. "Kur *Sofia* vjen në Shqipëri, më 7 mars të vitit 1914, ajo kujtonte se do të ndërtonte aty sallonet letrare, me të cilat ishte mësuar në Berlin. "Ajo ngriti një komitet, ku kishte ftuar gratë e bejlerëve më të rëndësishëm. Në këtë takim erdhi vetëm një bejlerëshë, e ve, të tjerat nuk lejoheshin të dilnin nga shtëpitë", tregon *Goetze*. Një shembull ky për të ilustruar se çfarë dallimi ekzistonte mes princshës dhe vendit të saj. 184 ditë zgjati qëndrimi i familjes princërore në vilën e ndërtonuar

enkas për ta në Durrës, kjo edhe falë intrigave të *Esat Pashë Toptanit*, asokohe ministër i Brendshëm, që më vonë u bë një nga armiqtë më të mëdhenj të princshës. "Ajo ka lexuar shumë libra të dobët", citohet të ketë thënë për princshën *Sofia* kryeministri i mëvonshëm i Shqipërisë. Ndërsa princ *Wiedi* deri në fund të jetës nuk hoqi dorë nga pretendimi për fronin shqiptar, që i kishte kushtuar gjithë pasurinë. *Sophie von Schoenburg Waldenburg* e kuptoi shumë shpejt që nga Shqipëria nuk do të kishte asgjë dhe iu kthye sërish jetës kulturore. Për një kohë të gjatë pas kthimit të saj në kështjellën prindërore në *Waldenburg*, ajo ishte parë të vërtetë me dy truproje shqiptare të veshura në kostume popullore që i drejtoheshin asaj me "lartmadhëria juaj". "Ndoshta në frëngjisht", mendon *Goetze*, sepse sado që u përpoq, *Sofia* nuk arriti të mësonte shqip". Në vitin 1920, ajo shkroi dhe një operë për *Skënderbeun*. Për fat të keq, *Lufta* e *Dytë Botërore* nuk ruajt asnjë gjurmë nga ky libret. *Sophie von Albanien* vdiq në vitin 1936, në moshën 51-vjeçare, në *Waldenburg*.

VITET E FUNDIT TE NJE GJENIU

Britanikët nuk dëshiron të humbisnin një shkrimtar kaq të madh, me famë botërore. Qarqet qeveritare e pyetën jo zyrtarisht, nëse do të pranonte nderimin me "Urdhrin e Meritës". Nuk pranoi. Përgjigja e tij mbeti në histori: "Një shkrimtar mund të nderohet vetëm pas vdekjes nga historia"

Grigor JOVANI

Lufta e Dytë Botërore, që shpërtheu më 3 shtator 1939 me pushtimin e shpejtë të Polonisë dhe ngjarjet dramatike që ndodhën në vazhdim, qenë një "shok" i vërtetë për Xhorxh Bernard Shoun, dramaturgun më të madh perëndimor të kohës. Thjesht u mpi, nuk mbajti qëndrim menjëherë dhe, si rrjedhim, u akuzua për indiferencë dhe utopi idiote, aq më shumë që kur vendosi të flasë, tek një artikull i bujshëm tek "New Statesman", ndërkohë që Rajhu i Tretë po përparonte me krime të frikshme qëllimet e tij, ai propozoi organizimin e një... konferencë paqeje. Por kjo nuk vazhdoi gjatë. Një mendje kaq gjeniale sa e tij nuk mund të ishte gjatë në gjendje... gjumi. Kuptoi shumë shpejt se konferencave të paqes u kishte ikur koha, kur kishin filluar ndërkohë gjerësisht luftimet ekspansioniste të nazistëve në të gjithë Evropën. Shou kërkoi publikisht që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të hynin në luftë, në krah të frontit antifashist.

Ndërkohë, krijimtaria e tij letrare nuk po shkakonte euforinë e mëparshme. Mbase ngaqë njerëzit e kishin mendjen në luftë. "Karroca e Alpeve" u prit ftohtë. Veprat e tij të mëparshme, i shpëtuan indiferentizmit të publikut dhe kritikës nga transferimi i tyre në skenat e përtej Atlantikut, në Amerikë, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Protagonistë të tyre ishin aktorë të njohur, si John Gielgud, Deborah Kerr dhe Robert Donat. Aty nga fundi i Luftës, më 1944, ngjiti përsëri në Londër veprat e tij, nëntë premiera të reja, duke përfshirë në to edhe kryeveprën "Armët dhe njeriu", me protagonistë Ralph Richardson, Laurence Olivier, Sybil Thorndike, Margaret Leighton. Dy agjenci teatrorë shëtitën veprat e tij në të gjithë Britaninë.

Shaw ndjehej i lodhur. Lufta e kishte dërmuar psikologjikisht. Bombardimet e Londrës nga "stuck"-ët gjermanë e detyronin herë pas here të strehohej në vilën e shkrimtares së njohur, Ansi Astor, mikes së tij, në Klavden. Gjatë vitit 1943, më i vështiri në Londër për sa u përket bombardimeve, familja Shaw u kthye në shtëpinë e tyre, në Whitehall Court, për shkak edhe të gjendjes shëndetësore të keqësuar të bashkëshortes Charlotte. Këtu mund të kurohej më lehtë dhe më mirë. Mirëpo, nuk i shpëtoi fundit fatal. Vdiq në shtator të atij viti.

Këteje e tutje, jeta Xhorxh Bernard Shout ndryshoi. Humbjen e të shoqes nuk e tejkaloi kurrë. Dëshpërimi erdhi për të mos u larguar asnjëherë, gjer në fund të jetës. Miku i tij, shkrimtari dhe kritiku i njohur irlandez St. John Greer Ervine, do të shkruante më 1959: "Vitet e mbetura të jetës së Shou-t ishin të qeta dhe vetmitare. Humbja e gruas ishte shumë më e ndjeshme se sa mund ta kishte parashikuar, më tepër se çdo humbje tjetër: sepse mburrej për një forcë stoike përballë çdo humbjeje dhe fatkeqësie."

Nuk kishte më dhe kaq qejf të shkruante letërsi. Për një kohë shkroi publicistikë politike, siç qe libri "Gjithçka është politikë. Çfarë është çfarë?", botuar më 1944. Por pa sukses. Politikani frënge-britanik Aleksander Holroyd i përshkruan këto përpjekje të Shaw-t si "rrëfime aventureske... ku përsëriten idetë e shkuara të shkrim-

tarit..." Të njëjtin fat patën edhe pamfletet e tij politike për Gjyqin e Nurembergut, ku dënoi - çuditërisht - "përndjekjen" e pasluftës të udhëheqësve të Rajhut të Tretë, si "akte vetëdrejtësie". "Jemi të gjithë kriminelë të mundshëm!", deklaroi Shou, duke ngjallur kudo në Perëndim reagime të shumta kundërshtuese.

Herë pas here ishin bërë përpjekje nga moderatorët e veprës së Shout të përcilleshin veprat e tij në kinematografi, që po popullarizohej gjithnjë e më shumë. Dramaturgët si ai kishin fjalën e nderit. Tre herë regjisorit të njohur Paskal i ishte dhënë mundësia të ngjiste në ekran veprën të Shout. Pa ndonjë sukses të madh. Së fundi, "Cezarin dhe Kleopatren", më 1945. U karakterizua nga kritika "dështimi më i madh ekonomik në historinë e kinematografisë britanike." Ndonëse në Amerikë filmi u prit disi më mirë dhe kritika nuk e sulmoi kaq sa në Britani, Shou ishte i pakënaqur nga gjithë përpjekjet e tij. I ngjante se po i sakrifikoje vepra, për të sponsorizuar dështimet e një regjisori. U shpreh në dëshpërim e sipër se "luksi i filmit anulon dramën e tij dhe në përgjithësi kjo veprë filmike është një imitim i keq i atyre të Cecil B. de Mille, në epokën e kinemasë pa zë..."

Më 1946 Shou ishte tashmë 90 vjeç. Ndërkohë që dëshira dhe mundësia për punë letrare po i zvogëlohej, qëndronte megjithatë në këmbë si një veprimtar i paepur dhe i pavarur shoqëror. Në vijë të parë. Si irlandez, pranoi çlirimin e Dublinit, pa përfillur qëndrimet konservatore në Londër. Megjithatë, britanikët nuk dëshiron të humbisnin një shkrimtar kaq të madh, me famë botërore. Qarqet qeveritare e pyetën jo zyrtarisht, nëse do të pranonte nderimin me "Urdhrin e Meritës". Nuk pranoi. Përgjigja e tij mbeti në histori: "Një shkrimtar mund të nderohet vetëm pas vdekjes nga historia".

Po këtë vit qarkulloi veprën "Krimi i burgut" (The Crime of Prisonment), një studim për kushtet në burgjet britanike, ide që po e punonte për njëzet vjet. Pati reagime pozitive të menjëhershme. Biles ndërkombëtare. "American Journal of Public Health" shkroi se "është e domosdoshme që këtë veprë ta sudiojë çdo student i juridiksionit të drejtësisë në Amerikë dhe në botë."

Paskëtaj shkroi veprat e tij të fundit, "Miliardat Buoyant" (1946), "Përralla të largëta" (1948) - një përmbledhje gjashtë veprash të vogla teatrale dhe "Shakes kundër Shou" (1949), një vit para se të vdiste. Kjo e fundit është tejet interesante. Një veprë dhjetëminutësh, ku Shekspiri dhe Shou shkëmbejnë fyerje. Sipari i tij artistik mbyllet me veprën "Përse ajo nuk do" (1950), të cilën vetë Shou e përshkroi si "një komedi e vogël", që u shkrua pak pas ditëlindjes së tij të 94-tët.

Vitin e fundit të jetës ia përkushtoi kopshtit. Kishte ca borxhe të vjetra me lulet... I ngjante se i kishte lënë jashtë kujtesës, harrim që ato krijesa nuk mund ta meritonin.

Mbylli sytë 94 vjeçar, në qetësi të plotë, nga pleqëria e thellë. Shkaku zyrtar, mosfunksionimi i veshkave, dëm që iu shkaktua kur u rrëzua nga një pemë që po e krasitet. Hiret e tij, së bashku me ato të së shoqes Charlotte u shpërndanë në kopshtin për të cilin përkujdeseshin.



TI DHE BOMBA ATOMIKE

Nëse bomba atomike do të ishte diçka aq e lirë dhe që prodhohet lehtësisht si një biçikletë apo një orë me zile, mund të na kishte zhytur përsëri në barbarizëm, por nga ana tjetër, mund të kishte nënkuptuar fundin e sovranitetit kombëtar dhe të shtetit policor shumë të centralizuar



George ORWELL

Duke marrë parasysh sa ka gjasa që ne të gjithë të bëhemi copë e çikë prej saj brenda pesë vjetëve të ardhshme, bomba atomike nuk ka ngjallur aq shumë diskutime sa mund të pritej. Gazetat kanë botuar diagrame të shumta, jo shumë të dobishme për njeriun mesatar, të protoneve dhe neutroneve prej të cilave përbëhen, dhe ka pasur shumë përsëritje të deklaratës së padobishme se bomba "duhet të vihet nën kontrollin ndërkombëtar". Por çuditërisht pak është thënë, gjithsesi në shtyp, për pyetjen që është me interes më urgjent për të gjithë ne, pikërisht: "Sa të vështira janë këto gjëra për t'u prodhuar?"

Informacione të tilla që ne - domethënë publiku i gjerë - zotërojmë për këtë temë, na kanë ardhur në një mënyrë mjaft të tërthortë, në kundërshtim me vendimin e presidentit Truman për të mos ia dorëzuar disa sekrete BRSS-së. Disa muaj më parë, kur bomba ishte ende vetëm një thashetheme, besohej shumë se ndarja e atomit ishte thjesht një problem për fizikanët dhe se kur ata ta kishin zgjidhur, një armë e re dhe shkatërruese do të ishte në dispozicion të pothuajse të gjithëve. (Në çdo çast, kështu vijuan thashethemet, një i çmendur i vetmuar në një laborator mund ta bëjë qytetërimin pluhur e hi, aq lehtë sa ndezja e një fishekzjarri.)

Nëse kjo do të ishte e vërtetë, i gjithë drejtimi i historisë do të ishte ndryshuar papritmas. Dallimi midis shteteve të mëdha dhe shteteve të vogla do të ishte fshirë dhe fuqia e shtetit mbi individin do të ishte dobësuar shumë. Megjithatë, nga fjalimet e presidentit Truman dhe komentet e ndryshme që janë bërë për to, duket se bomba është jashtëzakonisht e shtrenjtë dhe se prodhimi i saj kërkon një përpjekje të madhe industriale, siç janë në gjendje të bëjnë vetëm tre ose katër vende në botë. Kjo pikë është e një rëndësie thelbësore, sepse mund të nënkuptojë se zbulimi i bombës atomike, aq larg

nga ndryshimi i historisë, thjesht do të forcojë prirjet që kanë qenë të dukshme gjatë një duzine vitesh më parë.

Është gjë e zakonshme të thuhet që historia e qytetërimit është kryesisht histori e armëve. Në mënyrë të veçantë është vënë në dukje vazhdimisht lidhja midis zbulimit të barutit dhe përmbyesjes së feudalizmit nga borgjezia. Dhe megjithëse s'kam dyshim se mund të bëhen përjashtime, mendoj se rregulli i mëposhtëm do të ishte përgjithësisht i vërtetë: se epokat në të cilat arma mbizotëruese është e shtrenjtë ose e vështirë për t'u prodhuar do të prirën të jenë epokat e despotizmit, ndërsa kur arma dominuese të jetë e lirë dhe e thjeshtë, njerëzit e thjeshtë e kanë një shans. Kështu, për shembull, tanket, luftanijet dhe aeroplanët bombardues janë në thelb armë tiranike, ndërsa pushkët, mushqetat, harqet e gjata dhe granatat e dorës janë në thelb armë demokratike. Një armë e ndërlikuar e bën të fortin më të fortë, ndërsa një armë e thjeshtë - përderisa nuk ka një më të mirë - i jep kthetrat të dobëtit. Epoka e madhe e demokracisë dhe e vetëvendosjes kombëtare ishte epoka e mushqetës dhe e pushkës. Pas shpikjes së strallit dhe para shpikjes së kapsollës, mushqeta ishte një armë mjaft e efektshme dhe në të njëjtën kohë aq e thjeshtë sa mund të prodhohej thuajse kudo. Kombinimi i cilësive të saj bëri të mundur suksesin e revolucioneve amerikane dhe franceze dhe e bëri një kryengritje popullore një çështje më serioze sesa mund të ishte në kohën tonë. Pas mushketës erdhi pushka me fole fisheku. Ajo ishte një gjë deri diku e ndërlikuar, por ende mund të prodhohej në shumë vende, dhe ishte e lirë, kalohej lehtësisht kontrabandë dhe harxhonte pak municion. Edhe kombi më i prapambetur mund të rrokte pushkët nga një burim ose një tjetër, në mënyrë që boerët, bullgarët, abisananët, marokenët - madje edhe tibetanët - të mund të luftonin për pavarësinë e tyre, nganjëherë me sukses.

Por më pas çdo zhvillim në teknikën ushtarake ka favorizuar shtetin kundër

individit dhe vendin e industrializuar kundër atij të prapambetur. Ka gjithnjë e më pak vatra pushteti. Në vitin 1939 kishte vetëm pesë shtete të afta për të bërë luftë në shkallë të gjerë, dhe tani janë vetëm tri - në fund të fundit, ndoshta, vetëm dy. Kjo prirje ka qenë e dukshme prej vitesh dhe është vënë në dukje nga disa vëzhgues edhe para vitit 1914. E vetmja gjë që mund ta përmbyesë këtë realitet është zbulimi i një arme - ose, për ta thënë më thjesht, i një metode luftimi - që nuk varet nga përqendrimi të mëdha të fabrikave industriale.

Nga shenja të ndryshme mund të arrihet në përfundimin se rusët nuk e zotërojnë ende sekretin e prodhimit të bombës atomike; nga ana tjetër, ka një pajtim të përgjithshëm të opinionit publik se do ta zotërojnë brenda pak vitesh. Pra, kemi para nesh perspektivën e dy ose tre super-shteteve përbindësh, secili i zotëruar me nga një armë me të cilën miliona njerëz mund të zhduken brenda pak sekondash, duke e ndarë botën mes tyre. Është nxituar të hamendësohet se kjo nënkupton luftëra më të mëdha dhe më të përgjakshme dhe, ndoshta, një fund të qytetërimit të makinerive. Por supozoni - dhe me të vërtetë ky zhvillim më i mundshmi - që kombet e mëdha të mbijetuara bëjnë një marrëveshje të heshtur për të mos përdorur kurrë bombën atomike kundër njëri-tjetrit? Supozoni se e përdorin, ose kërcënimin për ta përdorur, vetëm kundër njerëzve që nuk janë në gjendje të hakmerren? Në atë rast ne jemi kthyer aty ku ishim më parë, i vetmi ndryshim është se pushteti është i përqendruar në duar akoma më të pakta dhe se perspektiva për popujt e nënshtruar dhe klasat e shtypura është akoma më e pashpresë.

Kur Xhejms Bërnëm shkroi Revolucionin menaxhues, shumë amerikanëve iu duk e mundshme që gjermanët do ta fitonin fundin evropian të luftës, dhe për këtë arsye ishte e natyrshme të supozohej se Gjermania dhe jo Rusia do të dominonin masën e tokës euroaziatike, ndërsa Japonia do të mbetej

zotëruese e Azisë Lindore. Ishte llogaritje e gabuar, por nuk ndikon në argumentin kryesor. Sepse fotografia gjeografike e Bërnëmit për botën e re ka rezultuar e saktë. Gjithnjë e më qartë sipërfaqja e tokës po ndahet në tri perandori të mëdha, secila e pavarur dhe e shkëputur nga kontakti me botën e jashtme, dhe secila e sunduar, nën një maskim apo një tjetër, nga një oligarki e vetëzgjedhur. Pazari se ku do të përcaktohen kufijtë vazhdon ende dhe do të vazhdojë për disa vjet, dhe i treti nga tre super-shtetet - Azia Lindore, e dominuar nga Kina - është ende potencial më shumë sesa realitet. Por lëvizja e përgjithshme është e pagabueshme dhe çdo zbulim shkencor i viteve të fundit e ka përshpejtuar.

Një herë na thanë se aeroplani kishte "hequr kufijtë"; në fakt, vetëm pasi avioni u bë armë serioze, kufijtë janë bërë përfundimisht të pakalueshëm. Dikur pritej që radioja ta promovonte mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar; ka rezultuar të jetë një mjet për të izoluar një komb nga një tjetër. Bomba atomike mund ta përfundojë procesin duke grabitur klasat e shfrytëzuara dhe popujt e të gjitha fuqive për t'u revoltuar dhe, në të njëjtën kohë, t'i vërë zotëruarit e bombës mbi bazën e barazisë ushtarake. Në pamundësi për ta pushtuar njëri-tjetrin, ka të ngjarë të vazhdojnë ta sundojnë botën mes tyre dhe është e vështirë të shihet se si mund të priset ekuilibri përveç ndryshimeve të ngadalta dhe të paparashikueshme demografike.

Para dyzet a pesëdhjetë vjetësh, H. G. Uells dhe të tjerë na paralajmëruan se njeriu rrezikon ta shkatërojë veten me armët e tij, duke lënë pas milingonat ose disa lloje të tjera që të mbijetojnë e të na zënë vendin. Kushdo që ka parë qytetet e rrënuara të Gjermanisë do ta çoj ndër mend edhe këtë nocion. Megjithatë, duke parë botën në tërësi, zhvendosja për shumë dekada nuk ka qenë drejt anarkisë, por drejt rivendosjes së skllavërisë. Mund të shkojmë jo drejt shkatërrimit të përgjithshëm, por drejt një epoke kaq tmerrësisht të qëndrueshme sa perandoritë e skllavërvë të antikitetit. Teoria e Xhejms Bërnëmit është diskutuar shumë, por pak njerëz i kanë marrë parasysh nënkuptimet e saj ideologjike - domethënë llojin e botëkuptimit, llojin e besimeve dhe strukturën shoqërore që, ndoshta, do të mbizotëronte në një shtet që ishte njëkohësisht i pamposhtur dhe në një gjendje të përhershme "luftë të ftohtë" me fqinjët.

Nëse bomba atomike do të ishte diçka aq e lirë dhe që prodhohet lehtësisht si një biçikletë apo një orë me zile, mund të na kishte zhytur përsëri në barbarizëm, por nga ana tjetër, mund të kishte nënkuptuar fundin e sovranitetit kombëtar dhe të shtetit policor shumë të centralizuar. Nëse, siç duket, është një objekt i rrallë dhe i kushtueshëm aq i vështirë për t'u prodhuar sa një luftanije, ka më shumë gjasa t'u jepet fund luftërave në shkallë të gjerë me koston e zgjatjes së pafundme të një "paqeje që nuk është paqe". (Tribune, 19 tetor 1945)

(Nga anglishtja: Granit Zela)

ZBAVITËSIT, AKROBATËT DHE MUZIKANTËT

Skulpturat e akrobatëve romaneskë e kanë prejardhjen e tyre nga antikiteti dhe nga statujat e performuesve Greqisë dhe të Romës, por qëndrimet e tyre në periudhën romaneske, sjellja dhe tiparet që u janë dhënë janë bërë të duken groteske dhe tregojnë se artistët romaneskë ndryshonin nga pararendësit e tyre klasik



Arti klasik nuk iu përshtat krejtësisht qëllimeve të tyre dhe modelet që morën ata siguroheshin që t'u ndryshonin proporcionet dhe t'u theksonin atributet e tyre më pak të bukura dhe kishin si qëllim prezantimin e burrit dhe të gruas me sjellje jonatyrale dhe të pavend, p.sh. gratë e Marta Marestay ose Blaignac, të cilat vështronin me ngulm poshtë fustanit të tyre duke lënë përshtypje si të paturpshme, ndërsa dhe akrobati në Saint Legeri Pons, i cili paraqitet duke ngritur këmbët mbrapa për t'i vënë mbi kokë, nga dhuna e veprimeve të tij se do të na përcjellë një mesazh, ashtu si akrobatët e paraqitur në kolonën Lurbano, të cilët simbolizojnë përlëshjen e burrit dhe qëllimin e tij për të nisur një jetë tokësore ose në këtë paraqitje stigmatizohet krenaria e tepruar e akrobatëve, kur i paraqesin me trupa të shtrembëruar, jashtë formës së tyre.

Artistët romaneskë synonin të kapnin shëmtinë në statujat e akrobatëve dhe të artistëve, por është interesante mendjemprehtësia e tyre, pasi pozicionet në të cilat kanë paraqitur artistët kanë shërbyer njëkohësisht edhe për të luajtur rolin e mbështetës për superstrukturën e abakut dhe njëkohësisht të simbolizojnë mbajtjen e peshës së mëkatit.

Origjina e kësaj mënyre të paraqituri nuk ishte diçka e re për artistët romaneskë, pasi përdorimi i skulpturave si kolona apo si pikë mbështetëse ishte përdorur më parë nga paraardhësit e tyre greko-romakë, siç ishin kariatidet dhe telamonidet ose atlantidet.

Në shumicën e rasteve këto figura paraqiten të zhveshura, duke zbuluar një pjesë të anatomisë së tyre me këmbë të hapura ose në pozicione të tjera të pamundura, mund të jenë të rrethuara nga bimë ose kafshë, të cilat i pëshpëritin atyre në vesh dhe sigurisht në çdo rast simbolizmi varion.

Në disa kisha paraqiten akrobat, të cilët kanë një këmbë që mbaron me kokë gjarpri. Këto njihen si anguipedes, figura domethënëse që gjymtyrët apo bishtat e tyre mbarojnë në koka dhe gjenden shumë shpesh në skenat romaneske dhe sigurisht dhe ky është një detaj i huazuar nga periudha klasike është një zhvillim i tritonëve të periudhës klasike. Akrobatet me këmbët unazë kanë një afri me sirenat, bishtat e të cilave mblidhen në dy anë, me fundet që mbahen në nivelin e shpatullës, duke prekur abaket ose duke dhënë mbështetje atyre dhe si në rastin e akrobatëve është një qëndrim që i jepte skulptorit fushë veprimi për detaje seksuale. Në saje të qëndrimit të tyre akrobatët janë gdhendur nëpër kisha për të qenë objekte talljeje dhe poshtërimiti.

Shkak për urrejtjen e Kishës ndaj tyre u bë jeta e tyre e pavarur dhe autonome, duke ngjallur zili tek ata që ishin lidhur nga feudalizmi në një vend të vetëm, ndërsa duartrokjet dhe popullariteti i tyre shkaktoan një lloj urrejtjeje dhe krijuan idenë se akrobatët ishin njerëz të gatshëm të toleronin krime të vogla, në mënyrë që të krijonin të ardhura për të mbijetuar. Kisha i shkishëroi ata dhe nxori ligje të ashpra dhe në këtë mënyrë dhe arriti të zvogëlonte në njëfarë mase aktet e imitimit, të numrave të shpejtësisë si dhe one night stand në të gjithë Evropën.

Por në këtë sipërmarrje të saj Kisha u ndodh në një situatë paksa të vështirë. Duke qenë se performancat e tyre zgjonin

njëfarë hareje te njerëzit e thjeshtë, teatri zgjoi një dyshim të thellë në gjirin e kishës, por vetë praktikat e Kishës ishin një lloj drame, pasi liturgjia mesjetare ishte e përpunuar dhe muzika dhe kërcimi ishin pjesë të pandashme dhe kryesore të ritualit.

Por dhe xhelozia luante rolin e saj, pasi këta zbatimës të llojeve të ndryshme gëzonin pëlqimin dhe mbrojtjen e aristokracisë, pavarësisht moslejitimeve të Kishës. Shtresat e larta dhe njerëzit e thjeshtë në një kohë me vështirësi dhe humbje të mëdha kishin nevojë për ta. Karlomagni ishte një figurë që shikohej me dashamirësi të zhonglerët e mëvonshëm, pasi ai ishte një nga mbështetësit e tyre dhe u dhuroi atyre gjithë tokën e Provansës dhe ata grumbulloheshin në oborret e anzhuinëve dhe plantagenëve në Francë dhe në Angli; këndonin eposet e mëdha heroike dhe ishin përgjegjës për shtrirjen gjithandej të kultit të dashurisë, një tjetër arsye për të cilën i mallkoi Kisha. Thomas de Cabham, nëndekani i Salisbërit dhe më vonë arkiepeshkop i Kanterbërit, ka shkruar një pendestar, ku klasifikon këngëtarët sipas një këndvështrimi kishtar: janë ata që vishnin maska groteske ose zbatimnin nëpërmjet një kërcimi ose gjestesh "të turpshme", që përdornin satirën ose talljen, këta të gjithë ishin të mallkuar; ata që përdornin instrumente muzikore për të kënduar këngë të ndyra nëpër bankete, gjithashtu ishin të mallkuar; por ata që këndonin në një shoqërim muzikor mbi jetët e shenjtorëve dhe princërve duhet të toleroheshin dhe vetëm këtyre duhej t'u atribuohet termi zhongler.

Zhonglerët e jugut performonin gjithçka që ishte popullore dhe gjatë performancave të tyre mblidheshin sharlantat dhe tregtarë shëtitës, grabitës çantash dhe xhepistë, tutor dhe prostituta, që i bashkoheshin turmës së entuziazmuar për të ushtruar aktivitetin e tyre të dyshimtë. Prej këtyre ndodhive, por dhe akteve mahnitëse të akrobatëve u krijua mendimi se të gjitha këto ishin vepër e djallit dhe se këta performues merrnin fuqitë e tyre supernatyrore nga vetë satana. Ndëlimet kishtarë vunë theksin e tyre te këngët e dashurisë, që gratë këndonin jashtë deryve të kishave.

Festat dimërore ka të ngjarë të ishin ato më të neveritshmet për Kishën. Saturnalet dimërore, të cilat më parë festoheshin në nëntor dhe Festivali i Vitit të Ri të Kalendave, u transferuan në fund të dhjetorit, duke koïnciduar kështu me festën më të rëndësishme kristiane, atë të Krishtlindjeve. Të gjitha këto akte kishin një mosmiratim kishtar dhe vazhduan deri në shek. XV dhe është interesante të theksojmë në këtë pikë vullnetin e priftërinjve lokal kristian për të marrë pjesë në aktivitete të këtilla të padëmshme, por për një kristian tërësisht blasfemike. Kisha bënte një sy të verbër ndaj karnavaleve duke ditur se njerëzit kishin nevojë për një periudhë lirie të shfrenuar për t'u kthyer më me dëshirë në status-quo-në e mëparshme.

Këto vazhdimësi të këtyre festivaleve mesjetare kanë një lidhje të konsiderueshme jo vetëm me shfaqjen e maskave, maskave të kafshëve dhe akrobatëve në kisha, por gjithashtu dhe me gdhendjen e ekzibicionistëve, pasi aktivitetet seksuale kanë qenë jo të rralla në këto kohë, më tepër për të shpartalluar klerin.

NUMRI I ARDHSHEM ME 20 GUSHT

HEJZA

05 KORRIK, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000